



RAPORT I VEPRIMTARISË VJETORE
Janar 2009 – Janar 2010

ANALIZË VJETORË

RRETH VEPRIMTARISË SË TVSH- së NË PERIUDHËN (Janar 2009 – Janar 2010)

1. Informacion statistikor

Ndonëse kjo analizë i referohet periudhës **Janar 2009 – Janar 2009**, statistikat e mëposhtme – për lehtësi krahasimi – do t'i referohen ashtu sikurse në analizën vjetore të vitit të shkuar, javës së tretë të muajit nëntor, pra respektivisht periudhës Nëntor 2008 – Nëntor 2009, si vijon:

Java 17 – 23 nëntor 2008

Gjithsej brenda një jave: 168 orë transmetimi gjithsej
(ose 136.5 orë pa lajme)

Nga këto:

Lajme (incl. lajmet anglisht): 28 orë ose 16.7 % e kohës së përgj.
Lajme („Zëri i Amerikës“): 3,5 orë ose 2.1 % e kohës së përgj.

Prodhuar: 122 orë = 72.6 % e kohës së përgj.
ose 89.4% të kohës në dispozicion

Mbuluar nga programacioni
(me arkiv): **14.5 orë** transmetimi

Java 16 – 22 nëntor 2009

Gjithsej brenda një jave:

168 orë transmetimi gjithsej
(ose 136.5 orë pa lajme)

Nga këto:

Lajme (incl. lajmet anglisht):

28 orë ose 16.7 % e kohës së përgj.

Lajme („Zëri i Amerikës“):

3,5 orë ose 2.1 % e kohës së përgj.

Prodhuar:

132 orë = 78,57 % e kohës së përgj.
ose **96,7 %** të kohës në dispozicion

Mbuluar nga programacioni
(me arkiv):

4.5 orë transmetimi

Java 20 – 26 nëntor 2006

Gjithsej brenda një jave:

168 orë transmetimi
(ose 147 orë pa lajme)

Nga këto:

Lajme:

21 orë ose 12.5 % e kohës së përgj.

Prodhuar:

28 orë = 16.7 % e kohës së përgj.
ose **19%** të kohës në dispozicion

Mbuluar nga programacioni
(me arkiv):

119 orë transmetimi

Përfundim statistikor:

1. Nga analizimi i shifrave të mësipërme rezulton se prodhimet në TVSH në harkun kohor të dymbëdhjetë muajve të fundit kanë pësuar një rritje prej mesatarisht **10 orësh** në javë, **78,57 %** të kohës së përgjithshme të transmetimit ose **96,7 %** të kohës në dispozicion të TVSH (pa kohën e edicioneve informative të Drejtorisë së Aktualitetit dhe Redaksisë së VOA).
2. Krahasuar me të njëjtën periudhë të fillimit të këtij mandati, rritja është në masën **579 %** të kohës së përgjithshme televizive ose 470 % të kohës së transmetimit në dispozicion të TVSH (pa kohën e edicioneve informative të Drejtorisë së Aktualitetit dhe Redaksisë së VOA).

2. Informacione të detajuara rreth ndryshimeve në strukturën programore të TVSH

Krahas vijimit të linjave kryesore të platformës së miratuar programore, në shërbim të rifreskimit të ekranit, në vitin 2009 u ndërmorën ndërhyrjet e mëposhtme:

- u rifaqos dhe ristrukturua emisioni **“Jo vetem kafe”**: rubrikave të përditshme **“Si të gatujmë”** dhe **“Aerobi”** iu shtua dekori i ri, i konceptuar për herë të parë në mënyrë krejtësisht konvencionale
- u rifaqos dhe ristrukturua emisioni **“Aktualitet përmes shtypit”** – u shtua dekori i ri, i konceptuar për herë të parë në mënyrë krejtësisht konvencionale
- u rifaqos dhe ristrukturua emisioni **“Kafeja e së dielës** – për herë të parë emisioni u pajis me një dekor të vetin ndryshe nga **”Jo vetëm kafe”**
- startoi të shtunën në mëngjes 7.00 – 8.00 emisioni i ri **“Palestër”** – me një program të plotë aerobie për moshë gjini të ndryshme
- startoi të shtunën në mëngjes 8.30 -10.00 emisioni i ri **“Sofra shqiptare”** - me traditën kulinarike shqiptare përmes një

udhëtimi sa real aq edhe imagjinar nëpër trevat e ndryshme të Shqipërisë

- startoi ditën e shtunë emisioni “Hopa kalamaja – loja filloi” - një variete për fëmijë, me një kohëzgjatje prej 90 minutash.
- startoi ditën e dielë emisioni “Mini mini shou” - një spektakël për fëmijë, më një kohëzgjatje prej 90 minutash.
- startoi ditën e shtunë dhe ditën e dielë paradite seriali vizatimor “Libri i madh i natyrës”, me një kohëzgjatje prej 30 minutash.
- startoi në mesditë seriali vizatimor “Libri i xhunglës”, me një kohëzgjatje prej 30 minutash (13.30 – 14.00) në kohën, kur fëmijët e ciklit të ulët janë kthyer nga shkolla dhe mund ta ndjekin.
- u rifaqos me një dekor krejtësisht konvencional dhe grafikë të re si edhe u plotësua me elemente spektakli emisioni “**Zik-Zak**”, i ndjekur nga rifaqosja dhe ristrukturimi i emisionit “**Troç**”.
- vijoi me intensitet të shtuar prodhimi i **programeve sportive**: në total llogariten mbi 580 orë transmetim, pra rreth 100 orë më shumë se në vitin 2008. Përveç emisionit të përjavshëm RUBRIKA SPORTIVE, ku kanë zënë vend krahas futbollit edhe sporte të tjera, si lojërat me dorë, peshëngritja, boksi etj. Si edhe transmetimit direkt të 1-2 ndeshjeve të futbollit në javë, në vitin 2009 hyri në transmetim të drejtpërdrejtë edhe EUROLIGA, përmbledhja e ndeshjeve të KUPËS së KAMPIONEVE si edhe ajo e kampionatit të futbollit Italian, spanjoll dhe anglez.
- Si një nga televizionet me eskuzivitet të plotë TVSH, ka transmetuar rreth 60 orë nga Kampionati botëror i atletikës, 35 orë nga Lojërat mesdhetare dhe 120 orë nga Kampionati europian i volejbollit - meshkuj dhe femra.

Prodhimeve të mirëfillta iu shtuan blerjet ose dhurimet e programeve vendase dhe të huaja, si

- 47 tituj – filmash artistikë të huaj (tituj të përzgjedhur të viteve të fundit), të blerë në fund të vitit 2009.

- Telenovela - 140 seri, një produkt latino-amerikan, i shfaqur me sukses në disa televizione publike të Europës Lindore dhe Juglindore
- Një paketë dokumentarësh të huaj për rubrikën “Dokumentar i huaj – premierë” - me informacion cilësor për ngjarje, epoka dhe figura të rëndësishme të historisë së njerëzimit.
- Paketa e fimit humoristik – **seria e klasikëve**, me dy koleksione komikësh të mëdhenj: 1. Koleksioni LAUREL dhe HARDY, ku përmblihen disa nga 100 filmat më të njohur të Laurel dhe Hardy, yjet e mëdhenj të Hollywoodit që prej 1930 deri në 1950.
- Paketa e dokumentarëve të ARTE (me minutazh prej 52 minutash).

U rifreskua sërish organizimi i përgjithshëm grafik i të gjitha formateve të TVSH, përfshirë dhe hapësirat ndarëse dhe harmonizimi i grafikave të emisioneve të veçanta me vizionin e përgjithshëm.

Rifilloi transmetimi i rregullt i “Programit ditor” – një paraqitje e përpunuar grafikisht dhe e ilustruar e ofertës programore ditore të TVSH dhe “Programit javor” – një paraqitje e përpunuar grafikisht dhe e ilustruar e ofertës programore javore të TVSH.

Brenda këtij koncepti, strukturimi i kohës televizive gjatë sezonit të dytë programor të TVSH për vitin 2008, për të gjitha fashë-oraret paraqitet si më poshtë:

- **Fashë-orari i mëngjesit
(nga e hëna në të premte)**

1. Telenovelë (rts) (6.00 – 7.00)
2. “Aktualitet përmes shtypit” (Leximi i shtypit dhe diskutim i temës së ditës me personalitete të ftuar në studio) (7.15 – 8.00)

3. “Jo vetëm kafe” (8.15 – 10.00)

- **Fashë-orari i mëngjesit**
(çdo të shtunë) (çdo të dielë)

1. “Palestër” (7.00 – 8.00)

2. “Sofra shqiptare” (8.15 – 10.00)

- **Fashë-orari i mëngjesit**
(çdo të dielë)

1. “Profka”/Film vizatimor (7.00 – 8.00)

2. “Kafeja e së dielës” (8.15 – 10.00)

- **Fashë-orari i paraditës**
(nga nga e hëna në të premte)

1. Ritransmetimi i mbrëmjes paraardhëse me renditje të përmbysur

b. Programi i kohës kryesorë televizive (10.15 – 12.00)

c. Telenovelë (12.00 – 12.50)

- **Fashë-orari i paraditës**
(në fundjavë)

1. “Mini mini shou” (10.15 – 12.00)

2. “Hopa kalamaja” (10.15 – 12.00)

3. Telenovelë (12.00 – 13.00)

- **Fashë-orari i mesditës**
(nga nga e hëna në të premte)

1. Film vizatimor “Libri i xhunglës” (13.30 – 14.00)

2. Emisioni “Zik-Zak” – emision i përditshëm për rininë (14.00– 16.00)

- **Fashë-orari i pasditës
(në fundjavë)**

1. Ritransmetim i debatit politik të javës “Log” (e shtunë)
2. Sport (e shtunë ose/dhe e dielë)
3. Film artistik shqiptar ose i huaj (e shtunë ose/dhe e dielë)

- **Fashë-orari i pasditës dhe mbrëmjes së hershme
(nga e hëna në të premte)**

1. Dokumentar i shqiptar (“Familjet e mëdha”) (e hënë: 16.45 – 17.45)
Emisioni “Katalogu kulturor” (e martë: 16.45 – 17.45)
Emisioni “Golat europianë të javës” (e mërkurë: 16.45 – 17.45)
Emisioni “Planeti muzikor” (e premte: 16.45 – 17.15)
Emisioni “Skaner” (e premte: 16.45 – 17.15)
2. Interval muzikor (17.45 – 18.00)
3. Lajme “Zëri i Amerikës” (18.00 – 18.30)
4. Lajme anglisht (18.30 -18.45)
5. Interval muzikor (18.45 – 19.00)
6. Telenovelë (19.00 – 19.50– nga e hëna në të premte)

- **Fashë-orari i pasditës dhe mbrëmjes së hershme
(e shtunë dhe e dielë)**

1. Telenovelë (rts) (16.45 – 18.00 /të shtunë dhe të dielë)
2. Lajme “Zëri i Amerikës” (18.00 – 18.30 – të shtunë/ të dielë)
3. Muzikë folklorike (18.30 – 19.00/ të shtunë)
4. Emisioni “Hapësirë e blertë” (19.00 – 20.00/ të shtunë)
5. Film humoristik (rts) (18.30 – 20.00/ të dielë)

- **Koha kryesore televizive**

1. e hënë: emisioni „7x7“ (20.45 – 22.25)
2. e martë: Film (20.45 – 22.25)

4. e mërkurë:	Premierë filmi	(20.45 – 22.25)
5. e enjte:	UEFA/ Film	(20.45 – 22.25)
6. e premte:	emisioni “Log”	(20.45 – 22.25)
7. e shtunë:	Film /spektakël (prodhim i RTSH)	(20.45 – 22.25)
8. e dielë:	emisioni “Rubrika sportive”	(20.45 – 22.25)

- **Fashë-orari i mbrëmjes së vonë
(nga nga e hëna në të premte)**

1. e hënë:	Film dokumentar premierë
2. e martë:	Film dokumentar premierë
3. e mërkurë:	“Teatri në ekran” ose koncert
4. e enjte:	Sport UEFA/ Film
5. e premte:	Film dokumentar premierë
6. e shtunë:	Film humoristik
7. e dielë:	Premiera e filmit dhe “Takim me kinemanë”

2. Faqosja, ka vijuar të mbetet një prej elementëve prioritarë për tërheqjen e vëmendjes së publikut. Ka përfunduar riorganizimi i përgjithshëm grafik i të gjitha formateve të TVSH, përfshirë dhe hapësirat ndarëse dhe harmonizimi i grafikave të emisioneve të veçanta me vizionin e përgjithshëm.

6.1. Gjithnjë brenda plotësimit të konceptit të përgjithshëm të faqosjes ka vijuar organizimi i promovimit të dy linjave (publicitetit të paguar, i cili përgjithësisht vjen i gatshëm, por kur nuk vjen, tentohet të faqoset në përputhje me standartet e vendosura) dhe promovimi të emisioneve të TVSH, të konceptuar si promovim standart (javor) dhe si konkret, (përputhur me edicionin e radhës)

6.2. Në shërbim të promovimit dhe propagandimit të formateve të ofruara, prej disa muajsh ka rifilluar të transmetohet rregullisht dhe “Programi ditor” – një paraqitje e përpunuar grafikisht dhe e ilustruar e ofertës programore ditore të TVSH.

Përfundime problemore:

1. Në periudhën janar 2009 – janar 2010 Drejtoria e TVSH detyrimin e vet ligjor për të zgjeruar spektrin e përfaqësimit të shtresave të ndryshme të popullsisë, duke eliminuar disa tregues defiqitarë. Kështu shtypi i ditës, i trajtuar historikisht shkarazi në TVSH zë aktualisht 5,5 orë në javë (nga 50 minuta në javë, që zinte më parë), programet për të rinj, gjithashtu tepër defiqitarë në kohë transmetimi zënë aktualisht afro 18 orë në javë (nga 30 minuta në javë, që zinte më parë) pa harruar këtu shtesën e transmetimet vjetor të programeve sportive, të cilat vitin e shkuar u ngritën në nivelin e 580 orëve.
2. Grila programore e TVSH arriti të stabilizohej përfundimisht si në dimension ditor – ditët e javës kanë “fytyrat” e tyre programore, ashtu edhe në dimension javor – përmes profizimit të fashë-orareve javore, me synim orientimin e teleshikuesve dhe krijimin targeteve të qëndrueshme të teleshikuesve.
3. Emisionet e manaxhuara nga Drejtoria e TVSH janë politikisht të ekuilibruara – formatet e debateve të konceptuar si hapësirë prononcimi për të gjitha forcat politike, strukturat e shtetit dhe shoqërinë civile, ndërsa prania e publikut në to hap mundësinë e paraqitjes së drejtpërdrejtë të mendimit të tij kritik.
4. Jo gjithmonë në mbështetje të këtyre dy përpjekjeve vjen plotësimi i detyrimit të institucionit tonë për pasqyrimin e veprimtarisë së parlamentit dhe institucioneve të tjera politike në vend. Çdo të hënë dhe të enjte – në përputhje me axhendën e Kuvendit të Shqipërisë TVSH është në pritje të lidhjes me të. Si kohëzgjatja e transmetimeve ashtu edhe momenti i fillimit të tyre nuk dihen saktësisht. Ato përcaktohen nga vullneti i punonjësve përkatës të shtypit, të cilët manaxhojnë situatën sipas rastit. Gjatë vitit në shqyrtim janë vërejtur disa raste ekstreme.

E udhës mbase do të ishte, që midis Kuvendit dhe institucioneve të tjera qendrore të vendit të lidhet një marrëveshje, në bazë të së cilës, monopolin e transmetimit të drejtpërdrejtë ta kenë vetëm ngjarjet e jashtëzakonshme (si p.sh. vizita e presidentit amerikan, protokolli i ftesës së antarësimit në NATO, zgjedhjet presidenciale në SHBA, etj.), festat kombëtare dhe fetare, të cilat e justifikojnë prishjen e programit, me synim informimin e publikut me të rejat e fundit ose hartimin e programit ditor në një formë të veçantë duke marrë parasysh axhendat e bëra të njohura kohë më parë. Në të gjitha rastet e tjera seancat e rëndësishme parlamentare mund të transmetoheshin në mbremje pas edicionit të informativ të orës 22.30, duke mos prishur rrjedhën normale të programit ditor dhe duke mënjanuar situatat e papastra teknikisht të reagimit të atypëratyshëm.

5. Viti në shqyrtim karakterizohet – siç e tregojnë edhe statistikat e mësipërme – nga një rritje e konsiderueshme e minutazhit në dispozicion të edicioneve informative (nga 21 në 31,5 orë në javë), e ardhur jo vetëm si pasojë e shtimit të edicionit të lajmeve të “Zërit të Amerikës” (30 minuta në ditë) dhe lajmeve në gjuhën angleze (15 minuta në ditë), por dhe nga zgjatja e edicioneve informative përtej minutazhit të miratuar në strukturat programore përkatëse me rreth 60 minuta në ditë. Mosrespektimi i orareve të përfundimit të lajmeve sjell me vete improvizim në përlllogaritjen e minutazhit të ndarjeve publicitare në përputhje me gjatësinë e emisioneve në vazhdim. Kështu ndodh që programet shtyjnë njëri-tjetrin dhe i fundit prej tyre – shpesh filmi vizatimor - pritet në mënyrë të pabukur në mëngjes herët (kur nuk ka turn programacioni) në prag të fillimit të emisionit “Aktualitetet përmes shtypit”.

*
* *

Rreth veprimtarisë vjetore të njësive të TVSH

DEPARTAMENTI I PROGRAMACIONIT

Departamenti i programacionit ka në përbërje të tij 3 sektorë.

1. sektorin e ndjekjes dhe hartimit të programit javor dhe ditor
2. sektorin e përkthimit
3. sektorin e grafikës

Sektori i ndjekjes dhe hartimit të programit

Detyra kryesore e sektorit të Ndjekjes dhe Hartimit të programit 24 orësh në TVSH, ka të bëjë me renditjen e programeve të dorëzuara në këtë sektor nga departamentet dhe sektorët prodhues sipas orareve të përcaktuara nga kolegji i TVSH, duke respektuar grupmoshat, interesat dhe pritjet e audiencës. Në këtë programim, renditen dhe promot e prodhuara nga sektori i grafikës, në shërbim të prodhimeve të firmuara nga TVSH, si dhe të programeve të blera prej saj. Nga Departamenti i marketingut pranë Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH, vjen çdo ditë lista e reklamave me pagesë, e cila gjithashtu menaxhohet nga sektori i Ndjekjes dhe Hartimit të Programit.

Shpërndarja e programeve televizive në një javë tashmë është fikse, çdo program ka orën dhe ditën e tij, duke llogaritur edhe programe që shkojnë në transmetim 1 herë në 2 javë (psh. Europa Ligue). Kjo shpërndarje ndryshon vetëm në rastet e lidhjeve direkte, si dhe në rastet (jo të pakta) kur edicionet informative kalojnë minutazhin e tyre të përcaktuar më parë me kronika apo reportazhe të zgjeruara nën sigletën Speciale.

Në mënyrë të përmbledhur më poshtë jepen orët (në sasi) e transmetimit të programeve sipas zhanreve televizive në harkun e një jave.

Edicione informative 26 orë

Lajme TVSH, lajme Zëri i Amerikës, lajme anglisht, Speciale

Programe të aktualitetit 11 orë

Log, Aktualitet përmes shtypit, Java në Parlament.

Programe sociale 30 orë

Zig-Zag, 7x7, Skaner, Trupi dhe Shëndeti, Hapësirë e blertë

Programe kulturore 5 orë

Planeti muzikor, Katalog kulturor, Takim me kinemanë

Film artistik dhe telenovelë 28 orë

Përveç të hënës, transmetohen 2 filma artistikë çdo ditë.
Ditën e mërkurën transmetohet filmi-premierë.

Programe të mëngjesit 14 orë

Jo vetëm kafe, Sofra shqiptare, Palestër, Kafe e së dielës.

Spektakël dhe koncerte 37 orë

Opera, Balete, Koncerte të huaja dhe të vendit

Emisione për fëmijë 3 orë

Mini mini shou, Hopa kalamaja

Filma vizatimorë 3 orë

Libri i xhunglës, Libri i madh i natyrës

Dokumentar shqiptar 2 orë

Dokumentari i huaj 5 orë

Reklama dhe spote 4 orë

Gjithsej në javë ofrohen 168 orë program

Të gjitha llogaritjet janë bërë duke marrë parasysh dhe **ritransmetimet**
Përsa i takon ndarjes së progameve të prodhuara për këtë sezon nga ato të
nxjerra nga arkivi do të llogarisnim:

Programe të prodhuara	135 orë
Programe të arkivit	33 orë

Departamenti i programacionit përbëhet nga

1. Sektori i hartimit dhe ndjekjes së programit

2. Sektori i përkthimit
3. Sektori i grafiës

Sektori i hartimit dhe ndjekjes së programit

Aktualisht në këtë sektor punojnë 3 redaktorë, të cilët kanë këtë ngarkesë :

- Hajrie Vika :**
1. hartim i draftit të programit
 2. menaxhim i kasetave
 3. monitorimi i tërheqjes dhe dorëzimit të programeve nga/në Arkivin e RTSH-së çdo ditë
 4. ndjekje e programit (emisioneve, reklamave dhe promote televizive, gjate 6 orëve te paradites.

- Gëzim Lika :**
1. redaktor në transmetim (sipas turnit)
 2. ndjekës programit gjatë turnit
 3. menaxhues i kohës televizive, në raste lidhjesh direkte (jo të pakta)

- Juliana Gerverni**
1. redaktore në transmetim
 2. ndjekëse e programit gjatë turnit
 3. menaxhuese e kohës televizive, në raste lidhjesh direkte (jo të pakta)
 4. hartuese draftit të programit (në mungesë të hartueses kryesorë)

Sektorit i përkthimit

Detyra e ketij sektori është të përgatisë për transmetim çdo format televiziv të huaj përfshirë dhe filmat artistikë dhe dokumentarë, të blerë nga TVSH ose të dhuruar. Punonjësit aktualë të ketij sektori janë të kualifikuar për të:

1. përkthyer formatet (filma, telenovela, dokumentare, sitcom, shfaqje tv)
2. Për t'i montuar ato, gati për transmetim.

Gjuhët e huaja nga të cilat përkthehet në këtë sektor janë:

anglisht, frengjisht, spanjisht, portugalisht, italisht dhe rusisht. Në rastet kur programet e huaja kanë qenë në gjuhën gjermane (filma artistikë dhe dokumentar) janë angazhuar me honorare përkthyes të jashtëm. Kjo ka ndihmuar në respektimin e afateve të daljes në transmetim të programeve premierë. E njëjta metodë pune është ndjekur edhe në rastet e përkthimit nga gjuha angleze (me dëgjim, pa skript), kur ngarkesa e punonjësve ka qenë në limit.

Ngarkesa e punonjësve të këtij sektori për vitin 2009 ka qenë si më poshtë:

- Ivana Tomço** 3 emisione X 30 min të Eurovision mbi Festivalin European në Moskë. (përkth, redaktim lexim, montazh)
7 dokumentarë nga 52min, nga Arte.(përkth, redakt, titrim)
30 seri të telenovelës “Dashuri Latine” (përkth, redakt, titrim)
52 episode të filmit vizatimor “Libri i xhunglës” (përkth, redakt, titrim),
6 Filma artistikë premierë (redakt, titrim)
5 materiale (minidok dhe shfaqja e Fifa – Afrika 2009)
- Donika Xhumari** 31 pjesë të telenovelës “Dashuri Latine”
(përkth, redakt, titrim)
20 episode të filmit vizatimor “Libri i xhunglës”
(përkth, redakt, titrim)
- Patris Paja** 28 pjesë të telenovelës “Dashuri Latine”
(përkth, redakt, titrim)
8 reportazhe (për emisionin Troç) (përkthim)
10 dokumentarë nga Deutsche Wlle (përkthim)
1 dokumentar për Festivalin European
- Ivzi Koci** 16 dokumentarë 52-60min (përkth, redakt, titrim)
10 dokumentarë 30min (përkth, redakt, titrim)
37 pjese te telenoveles (përkth në bashkëpunim, redak, titrim)
- Enver Leka** 13 dokumentarë 10 min “Historia e fshehtë e futbollit”
(përkth)
30 pjesë të telenovelës “Dashuri Latine”
(përkth, redakt, titrim)

Rendimenti i pabarabartë i punonjësve ka sjellë shpërndarja e ngarkesës të ndryshme, çka ka ndikuar shpesh në krijimin e stresit para transmetimit. Një mangësi tjetër në këtë sektor është mungesa e realizimit të promocioneve për programet që përgatiten. Disa promo mbi premierat e dokumentarëve të ditëve të hëna e të marta, si dhe të filmit të së mërkurës janë realizuar me sforcim. Për të filluar me premiera sezonin e ri televiziv (shtator 2009-qershor 2010) në këtë sektor kanë mbërritur për t'u punuar këto programe të huaja:

- 120 seri të telenovelës (transmetimi i të cilave ka filluar)
- 52 dhe 54 seri të dy filmave vizatimorë (në transmetim dhe në proces përkth)
- 41 filma humoristikë (në transm dhe ne proces)
- 34 dokumentarë nga ARTE (në transmetim dhe në proces përkthimi)
- 6 dokumentarë - fitues të çmimit PRIX nga Circom regional
- 47 filma artistikë nga shtëpitë me të shquara hollivudiane etj.

Sektori i Grafikës

Në përbërje të këtij sektori janë 7 punonjës
1 koordinator dhe 6 grafistë

Detyrat kryesore të këtij sektori janë:

1. krijimi artistik i spoteve promovuese për shumicën dërrmuese të emisioneve të programuara për transmetim, qofshin këto të firmuara TVSH apo të huaja.
2. krijimi i faqosjeve dhe siglave të emisioneve.
3. realizimi i fluturave, sigletave, autoreklamave, lupave, titrave të ndryshme etj.
4. rifreskimi i të gjitha spoteve e siglave pas një numri të caktuar transmetimesh.

Sektori i Grafikës gjatë vitit 2009 realizoi këtë volum pune:

Spote	91
Faqosje	26
Sigla	10
Flutura	7
Sigleta	12
Projekte	2
Tabela	9
Perpunime	40

Titrimë	1
Autoreklama	1
Skenografi virtuale	1
Lupa	1
Publicitet promo	6
Urime festash	5

Aftësia teknike, krijimtaria dhe realizimi për secilin grafist paraqitet si më poshtë:

Armand Islami

Maya 3D, Digital Fusion, Liquid Edition, Adobe Audition, Photoshop

Projekt / emisionet sportive, 7x7, Puls, Lajmet

Krijime të tjera / spote , sigla, autorëklama

Artur Bejkollari

Lightwave 3D, Adobe Premiere, Photoshop, Adobe Audition, Dayang.

Projekt / Emisionet e femijeve, Programi ditor

Krijime të tjera / spote , sigla, skenografi

Benet Broja

Lightwave 3D, Digita Fusion, Photoshop, Adobe Audition

Projekt / Emisionet e mëngjesit

Krijime të tjera / spote, sigla, autoreklama

Arber Malile

3D MAX, Digita Fusion, Adobe Premiere, Photoshop, Adobe Audition, After Effects, Illustrator, Liquid Edition, DPS

Projekt / filmi artistik (premiera, filmi humoristik)

Krijime të tjera / spote , sigla.

Ilvis Ceku

Lightwave 3D, Photoshop, Digital Fusion, Apremiere, DPS, Liquid Edition

Krijime / spote , sigla

Realizime / përpunim grafik

Albert Thomai

Maya 3D, DPS, Photoshop, Dayang, Digital Fusion, Adobe Premiere, Adobe Audition

Krijime / spote, sigla, postera

Realizime / përpunim grafik

Gjatë këtij sezoni televiziv pati disa ndryshime ne organizimin e punës. U shkëputën nga studiot e grafikës pajisjet që shërbenin për marrjen e materialeve bruto dhe u vendos që në këto studio të bëhen montazhe, vetëm në raste shumë urgjente për nevojat e programacionit .

Këto pajisje Beta Rec, Divicam Rec dhe dvd Rec shërbyen për të funksionuar një studio montazhi Nr5 në shërbim të sektorit të grafikës, në të cilën çdo krijues përgatit materialin nga ana e përmbajtjes dhe regjisë, mbi të cilën më pas punon grafisti.

Ky ndryshim rriti profesionalizmin e bashkëpunimit midis krijuesve të televisionit dhe grafistëve si dhe shkurtoi kohën e këtyre të fundit për realizimin e spoteve.

Megjithatë për sektorë si ai i Hartimit dhe Ndjekjes së Programeve dhe ai i Përkthimit ka akoma vështirësi në realizimin e promote, pasi në këta sektorë nuk ekziston një krijues i kualifikuar në promovimin e disa programeve të caktuara. (psh. filmi artistik, dokumentari i huaj apo formate të tjera të huaja)

DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE TË STRUKTURËS

Konsiderata të përgjithshme.

Për vitin 2009 në Departamentin e Programeve të Strukturës do të veçonim këto dukuri pozitive:

1. Është shtuar ndjeshëm koha e transmetimeve sportive, duke përfshirë këtu edhe ngjarje të tilla si EUROLIGA, përmbledhja e ndeshjeve për KUPËN E KAMPIONEVE, si dhe kampionati italian, anglez dhe ai spanjoll.
2. Emisioni i mesditës ZIG-ZAG përveç një tematike të përzgjedhur është pasuruar me elementë të spektaklit, duke u krijuar mundësi interpretuesve të rinj të shkollave të mesme të muzikës, si dhe talenteve të tjera.
3. Emisionet për fëmijë kanë krijuar një fizionomi tjetër si koncept dhe realizim, duke patur si bashkëudhëtarë fëmijë të moshës parashkollorë dhe ata të moshave 7-12 vjeç.
4. Futja e rubrikave fikse, të rikonceptuara, apo të reja si: JO VETËM KAFE, SOFRA SHQIPTARE, ZIK-ZAK, apo KAFEJA E SË DJELËS me një tematikë të seleksionuar ka bërë të mundur që t'i

shmangemi dublimit të temave apo personazheve, dukuri që e patëm gjatë vitit që lamë pas.

Spektori i mëngjesit

Pjesë përbërëse e fashë orareve të mëngjesit janë tre emisione, JO VETËM KAFE, SOFRA SHQIPTARE dhe KAFEJA E SË DJELËS, gjithsej 90 minuta secila. Në total, në programet e mëngjesit kanë zënë një hapësirë prej 432 orësh.

Spektori i programeve të mesditës

Spektori i programeve të mesditës mbulon programin e mesditës, të titulluar ZIG-ZAG, i cili shënon “markë” në programet tona dhe një peshë të konsiderueshme në orët e transmetimit.

Spektori i programeve për fëmijë

Sezoni televiziv 2009 për programet e fëmijë solli dy formate të reja me rreth tre orë program në javë: të shtunën dhe të djelën, të cilat realizohen në mjediset shumë interesante të kompleksit BLUR.

EJA KALAMAJA, LOJA FILLOI - në mënyrë didaktike argëtuese, emisioni merr përsipër të orientojë në edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore. Në program, përveç konkursit ndërthuren histori të personazheve të përrallave dhe filma vizatimorë.

MINI-MINI SHOU, ku rreth 10 fëmijë vihen në rolin e gazetarit dhe me pyetjet e tyre, shpesh interesante dhe naive, i sjellin të rriturit, pranë botës dhe preokupimeve të tyre.

Plane:

Me interes për botën e fëmijëve do të ishte konkursi për nxënësit e 9-vjeçares. Për këtë janë hartuar platformat, mënyrën e realizimit, mjetet dhe fondet e domosdoshme.

Spektori i emisioneve tematikë

Peshën kryesorë në këtë sektor e mbajnë programet sportive, ku në total llogariten mbi 580 orë transmetim, pra rreth 100 orë më shumë se në vitin 2008. Përveç emisionit të përjavshëm RUBRIKA SPORTIVE, ku kanë zënë vend krahas futbollit edhe sporte të tjera, si lojërat me dorë, peshëngritja, boksi etj., vlen të përmendet fakti se në 2009-ën hyri në transmetim direkt

EUROLIGA, si dhe përmbledhja e ndeshjeve të KUPËS së KAMPIONEVE, dhe ajo e kampionatit të futbollit italian, spanjoll dhe anglez.

TVSH, ka transmetuar rreth 60 orë nga Kampionati botëror i atletikës, 35 orë nga Lojërat mesdhetare dhe 120 orë nga Kampionati evropian i volejbollit meshkuj dhe femra.

Plane

1. Për ngjarje sportive që do të zhvillohen si Lojërat dimërorë të Vankuverit, apo Kampionati botëror i futbollit AFRIKË 2010 nga departamenti do të ketë platforma të veçanta për mënyrën e transmetimit, faqosjen, dekorin, spotet, të ftuarit etj.

2. Janë përgatitur platforma për një cikël dokumentarësh për figura të cmuara dhe klube sportive me zë si Tirana e viteve 70, Vlora e viteve 80 etj.

Në 6-mujorin e parë të vitit 2009 në programin e TVSH-së ishte edhe emisioni PULS. Cikli u mbështet në tre faktorë: informacion statistikor, opinion i publikut për temën në fjalë dhe material arkivor. Tematika preku probleme të tilla si marrëdhëniet midis brezave, bashkëjetesa dhe divorci, kufinj të humanizmit, toleranca etj., pra tema të ditës me karakter të mprehtë social.

Rubrika SKANER, ndonëse jo me ritmin që kërkohet, për vitin 2009 ka transmetuar rreth 10 emisione për probleme të tilla si erozioni i tokës, aksidentet, fati i kopshtit zoologjik, hotel Tiranës e deri te parqet nënujorë, si vlera të ekonomisë sonë. Synojmë në përzgjedhjen e një problematike interesante, të ditës dhe shteruese.

Emisione të tilla si 7x7, MJEKU, TROÇ vazhdojnë të ruajnë përvojën e mirë që kanë patur dhe ndonëse ndonjëherë kanë dalë nga formati për t'iu përgjigjur një problemi më të mprehtë se sa ato të javës ku mbështeten zakonisht.

Në sektorin tematik vazhdon të ruhet tradita e dokumentarit PORTRET si një nga gjinitë që e dallon TVSH nga televizionet e tjera. Janë përgatitur dokumentarë për figura të tilla si Mentor Xhemali, Muzafer Xhaxhiu, Thoma Kaçorri, Ekrem Kryeziu, Panajot Pano etj, ndërsa për personalitete të tilla si prof. Çabej, prof. Selman Riza, etj., janë zhvilluar biseda në studio duke i gërshetuar me materiale arkivorë.

Ndërkaq ka mbetur pa realizuar cikli i emisioneve për historikun e pikturës shqiptare.

Ndërkaq ka filluar puna për realizimin e ciklit të dokumentarëve “Shqipëria në focus”.

Përmes këtyre dokumentarëve synohet të jepet një pamje e zhvillimeve dhe ndryshimeve që kanë ndodhur në qytete më të mëdha të vendit në fushën e traditave kulturore e historike, të ndërtimeve dhe planeve urbanistike perspektive, në atë të prodhimit dhe të inisiativës private, të turizmit dhe figurave më të njohura (qytetarë nderi), që janë si të thuash “ikonat” e këtyre qyteteve. Janë gjithësej 12 dokumentarë për Tiranën, Durrësin, Vlorën, Shkodrën, Elbasanin, Korçën, Gjirokastrën, Fierin etj., ku synohet të gjendet e veçanta e çdo qyteti dhe që e dallon atë nga të tjerët.

DEPARTAMENTI I SPEKTAKLIT DHE FILMIT

Në prurjet programore të vitit, një peshë të konsiderueshme – megjithë numrin e vogël të bashkëpunësorëve të brendshëm – ka mbajtur edhe Departamenti i spektakleve dhe i filmit. Vulën e tij mbajnë seritë kryesore të spektakleve të prodhuara në TVSH, në bashkëpunim me të tretë ose të përpunuara prej TVSH vetëm nga ana televizive. Nëpërmjet forcave të këtij departamenti dhe me mbështetjen e Departamentit të prodhimit realizohen konkretisht të gjitha bashkëpunimet e TVSH me institucionet kryesore artistike në vend dhe më gjerë.

Por angazhimi i përkushtuar i forcave krijuese të këtij departamenti nuk e mbulon dot mungesën e një spektakli të prodhuar nga vetë TVSH. Mënjanimi këtij deficiti, siç e ka treguar përvoja e deritanishme kërkon fillimisht përgatitjen e kushteve për startimin e një iniciative të tillë dhe më pas hapjen e konkursit për projektin më të mirë.

Angazhimet konkrete:

1. Osman Mula - Drejtor departamenti

15 aktivitete artistike ndër të cilët veçohet

Festivali i 48-të i Këngës në RTSH - regji skenike, regji televizive live

Festivalit Kombëtar i Këngës për fëmijë në Shkodër - regji skenike, regji televizive live

1 emision i përjavshëm (LOG)

2. Regjisorët:

1. Petri Bozo

Mars – Maj / 2009 – Spektakli “Netët e Klipit Shqiptar”

Nëntor / 2009 – Miss Kontinenti

Dhjetor / 2009 – Koncerti “Tre Tenorët”

2. Arjan Çuliqi

Filmi humoristik “Para nga qielli”

3. Ilir Buçpapa

Dokumentari për Malësinë e Madhe - trasmetuar në Tetor / 2009

4. Esat Teliti

Emisioni “Na iku një mik” Ceremonia e varrimit të Artistit të Popullit Viktor Gjika

15 aktivitete politike, sportive dhe artistike - regji televizive dhe montazh

5. Leonard Gjata

35 aktivitete artistike – regji televizive dhe montazh

6. Llesh Nikolla

15 aktivitete politike, sportive dhe artistike ndër të cilët Festivali Kombëtar i Gjirokastrës, Sofra Dardane, Kënga dhe vallja çame - regji televizive dhe montazh

2 emisione të përjavshme (7X7 dhe Aerobi/Palestër)

1 dokumentar

3. Redaktorët:

1. Sonila Djepaxhija

40 aktivitete artistike – përgatitje për regjistrim dhe montazh

2. Marita Zykaj

Emisioni i përjavshëm „Katalogu kulturor“

3. Mirjana Rusi

Emisioni i përjavshëm “Planeti muzikor”

2 aktivitete artistike – montazh

DEPARTAMENTI I PRODHIMIT

Drejtoria e Prodhimit ka përballuar një volum të madh pune gjatë vitit 2009. Duke qenë një krijesë mes dispeçerit dhe gjeneratorit të asaj që realizohet nga Televizioni Shqiptar, Departamenti i Prodhimit është përpjekur të krijojë një “pistë” sa më të favorshme për të gjitha kërkesat e parashtruara nga Drejtoritë e tjera, sidomos nga ajo e **PROGRAMEVE TË STRUKTURËS**. Natyrisht që të angazhohesh në realizime televizive për plot 365 ditë, do të lësh pas vetes gjithmonë gjëra, që mbetet për t’u bërë më mirë, herë për mungesa të momentit, herë për mbingarkesë e herë gabime neglizhence apo pamundësie realizimi. Gjithsesi, e përgjithshmia mbetet pozitive. Por, le t’i marrim me radhë në një vështrim sintetizues, hallkat përbërëse të Departamentit të Prodhimit, me realizimet dhe problemet e tyre për vitin 2009 dhe kërkesat e alternativat përmirësuese për vitin 2010:

Spektori i grupeve të xhirimit

Gjatë vitit 2009, në këtë sektor është punuar me ngarkesë të plotë dhe në disa raste edhe me mbingarkesë. Duke u nisur nga rëndësia e kësaj hallke të Departamentit të Prodhimit për shumë emisione ka patur rritje të cilësisë së figurës dhe fantazisë së xhirimeve.

Vlen për t’u nënvizuar gatishmëria e këtij sektori në përballimin me sukses të transmetimit apo pasqyrimin të të gjitha evenimenteve politike, kulturorë e sportive në vend, ku spikasin Zgjedhjet Parlamentare 2009, konferencat e shpeshta për shtyp, mbledhjet qeveritare, pritjet presidenciale, spektaklet e ndryshme, ndeshjet kombëtare e ndërkombëtare të futbollit etj. Sektori ka përballuar një ngarkesë të pazakontë, shpesh edhe në kushtet e emergjencës.

Por ka patur edhe probleme të dala nga puna gjatë vitit të fundit.

Një ndër pikat kryesore dhe që është bërë problem është mosbindja e ndonjëherëshme e ndonjë operatori apo shoferi. Në raste të tilla, nga ana e Drejtorisë së Televizionit, është dhënë urdhër për masa administrative ndaj punonjësve problematike. Por nga ana e Drejtorisë së Prodhimit është ngurruar apo dhe toleruar, duke menduar se vërejtjet e rastit, do të ndikonin pozitivisht në mbarëvajtjen e punëve.

Për të gjitha emisionet dhe programet e strukturës së Televizionit Shqiptar si “Jo vetëm kafe”, “Kafja e mëngjesit”, “Sofra shqiptare”, “Zig-

zag”, “Rubrika sportive”, “Skaner”, “Mjeku për ju”, “Katalog kulturor”, “7 x 7” si dhe dokumentarët dhe reportazhet e ndryshëm, koncertet e spektaklet, ngarkesa e punës për vitin 2009, është rreth 400 – 500 dalje të grupeve të xhirimit.

Për vitin 2010, mbetet të forcohet edhe më tej disiplina në zbatimin e detyrave të ngarkuara.

Sektori i studiove

Sektori i studiove në Televizionin Shqiptar ka përballuar një vit me një fluks prodhimi. Ngarkesa e punës është ndarë si në studion e televizionit ashtu edhe në realizimet e kryera në ambiente të tjera, në transmetime direkte apo të rregjistruara.

Ngarkesa e transmetimeve javore, ku jep kontributin sektori i studiove është afro 30 orë (duke llogaritur këtu vetëm orët e transmetimit, jo ata të përgatitjes së studios apo çmontimit të skenografive). Në muaj, kjo ngarkesë shkon rreth 120 orë.

Nga ana tjetër, koha mesatare për të ngritur një dekor është 2 orë dhe për çmontimin e tij rreth 1 orë e 30 minuta, duke e çuar në 3 orë e 30 minuta ciklin e plotë të procesit. Për 7 emisione në javë, koha shkon në 231 orë dhe në muaj diçka më shumë se 1 000 orë.

Në sektorin e studiove, pa llogaritur marangozat, punojnë gjithsej 13 vetë. Nëse bëhet një llogaritje ditore e ngarkesës, i bie të jetë 7.9 orë në ditë për person, pa llogaritur këtu orët e punës për: Transport dhe punë të ndryshme brenda institucionit si dhe transporte jashtë institucionit të mjeteve të teknikës, që nuk na takojnë si kran, plazma etj.

Problemet shqetësuese në sektor janë:

- Inventarizimi.

Ka shumë materiale që duhen nxjerrë jashtë përdorimit , gjë që duhet parë me vëmendje. Ndërkaq emërtimi i materialeve që blihen është gati skandaloz, sepse kërkohen me faturë dhe nuk kanë shenja dalluese, apo shpjegime se cilit emision i përkasin.

- Dekoret.

Sektori nuk mund të parashikojë dot se kur do të bëhen dekorë dhe as për nevoja të ngutshme.

- Perdet.

Dy perdet e studios janë në gjendje të rrezikshme. Janë vënë që në vitin 1982 dhe janë jashtë çdo kushti, madje edhe në rrezik nga zjarri.

- Marangozët.

Gjendja në sektorin e marangozëve është e turbullt. Ata i komandon kushdo dhe asnjë. Duhet parë edhe angazhimi i tyre. Kanë bërë punë të pjesshme për nevojat e institucionit. Ka nevojë për një punë të programuar, nëse do të jetë e mundur.

- Mbikoha.

Sektori angazhohet edhe të shtunat, të dielat edhe në ditët e festave të ndryshme. Duhet verifikuar orët shtesë dhe duhet gjetur një zgjidhje; pagesa ose pushimi, i cili për këtë sektor duket pak i paarritshëm.

Sektori i kameramanëve

Megjithë numrin e pakët të kolektivit, sektori i kameramanëve ka punuar me përkushtim dhe ka realizuar të gjitha kërkesat e paraqitura nga Departamenti i Prodhimit si në studiot brenda TVSh, ashtu edhe në transmetimet e realizuara me studiot lëvizëse.

Të gjitha emisionet e Drejtorise së Televizionit Shqiptar, madje edhe ato të Drejtorisë së Aktualitetit, që nga emisionet e studios e deri te ndeshjet ndërkombëtare dhe spektaklet e përmasave të mëdha, ku spikat Festivali tradicional i Këngës, janë përballuar me përgjegjësi dhe profesionalizëm nga kameramanët e sektorit.

Por nga ana tjetër, nuk mund të lihen pa përmendur edhe raste sporadike të shfaqjes së neglizhencës në mobilizimin e forcave për t'iu përgjigjur si duhet kërkesave të regjisorëve për realizimin e emisioneve. Ka patur edhe raste të tensionimit mes palëve, por për fat të mirë, ato kanë qenë të pakta dhe kanë gjetur zgjidhje dhe mirëkuptim.

Përsa i përket disiplinës në punë, ajo është zbatuar me korrektësi. Zbatimi i orarit ka ndihmuar mbarëvajtjen e punëve. Ndërkaq mungesa apo

largime të parakohshme nga puna kanë qenë të rralla dhe për raste të tilla, punonjësve përgjegjës u është tërhequr vërejtje nga Departamenti i Prodhimit.

Pavarësisht konstatimeve të mësipërme, mbetet akoma punë për të bërë në drejtim të të gjitha kërkesave në rritje, për realizimin e emisioneve.

- Nevojat janë të tilla, sa duhet parë mundësia për shtimin e sektorit edhe me të paktën 3 kameramanë.

- Rifreskimi i sektorit me elementë të rinj në moshë është i domosdoshëm, duke marrë parasysh edhe faktin se një pjesë e kameramanëve janë në prag pensioni. Afrimi i të rinjve pranë kameramanëve me përvojë, do të lehtësojë boshllëkun që mund të lerë, largimi i këtyre të fundit pas një kohe të afërt. Ky propozim, do të ndihmojë patjetër perspektiven e Televizionit Shqiptar.

Regjisorët

Regjisorët e Drejtorisë së Prodhimit, kanë qenë të angazhuar për të përmbushur detyrat e ngarkuara gjatë vitit 2009.

Me aktivet në realizimet televizive, kanë qenë Paulin Shkjezi, Ilir Bega dhe Enson Mula, që kanë qenë rregullisht në transmetim në realizimet e strukturës programore të vitit si “Zig-Zag”, “Rubrika Sportive” apo emisione të tjera të studios, qofshin sportive ashtu edhe artistike. Nga ana tjetër, ata janë angazhuar në mënyrë profesionale edhe në realizimet e permasave më të mëdha si Festivali i Këngës, ndeshjet ndërkombëtare dhe Programin e Madh të Vitit të Ri.

Edhe regjisorja Eli Bici, e cila punuar kryesisht me emisionin “Mjeku për ju”, është angazhuar së fundmi me faqosjen televizive të programeve të Televizionit Shqiptar.

Montazhi

Viti 2009, ka sjellë në montazh futjen e teknologjisë së re. Ky është hapi më i rëndësishëm në sektorin e montazhit. Natyrisht që ky është një hap pozitiv dhe duhen vlerësuar maksimalisht edhe kurset e organizuara nga Drejtoria.

Por duke e vlerësuar si hap, ndoshta duhet lënë edhe pak kohë në dispozicion të punonjësve, për ta bërë të vetin këtë lloj montazhi. Nga ana

tjetër, ndoshta duhej parë lënia e hapësirës edhe për më shumë montazhe të sistemit linear, për shkak se shumë nga gazetarët apo regjisorët, kane ende pune me këtë lloj montazhi dhe preferojnë të vijojnë procesin me të. Nga ana tjetër kjo do të ndihmonte në një kalim më të butë nga njëra teknologji në tjetrën.

Një shqetësim tjetër mbetet mosplotësimi i studiove me montazhierë. Në kalimin me 7 studio, ka ende mundësi për futjen e të paktën edhe të 1 montazhierë.

DEPARTAMENTI I TEKNIKËS

Viti 2009 ishte një vit i vazhdimësisë së ndryshimeve teknologjike në Televizionin Shqiptar.

U rrit teknologjia e pajisjeve televizive moderne në një nga sektorët më të rëndësishëm të televizionit siç është ai i montazhit, duke shtuar në këtë sektor pika të reja të montazhit jo-linear (kompjuterik), gjë që radhiti TVSH në krah të televizioneve më të mira të vendit. Gjithashtu për herë të parë u futën një sërë sistemesh rregjistrimi dhe riprodhimi në servera, krahas atij ekzistues, që lehtësoi punën e transmetimit të programeve të paraproduara, gjë që rrit sigurinë e transmetimit, sidomos në kushtet e televizionit tonë, kur teknologjia e vjetër e rregjistrimit dhe riprodhimit në shirit mangetik ka shfaqur probleme serioze dhe njëkohësisht krijoi mundësinë e transferimit të drejtpërdrejtë nga pikat e montazhit në serverat e sipër përmendur. Rezultatet e këtij inovacioni teknologjik u dukën menjëherë, ashtu siç u dukën menjëherë, për fat të keq edhe magnësitë në nivelin e aftësive teknike të domosdoshme për përdorimin e kësaj teknologjie. Për këtë problem kam ndërmend të flas mëposhtë.

Në vijim të përmirësimit teknologjik të TVSH, u futën një sërë pajisjesh të reja në aparaturën qendrore dhe po bëhet e gjithë puna e nevojshme për të lidhur në sistemin e televizionit edhe routerin e ri, i një cilësie me të vertetë të lartë, që do të krijojë një siguri tepër të madhe në shpërndarjen e të gjitha burimeve të sinjaleve audio dhe video në çdo pikë të TVSH. Theksojmë se të gjitha punimet për instalimin e teknologjisë së re janë bërë tërësisht nga personeli inxhiniero-teknik i TVSH.

Të bindur që puna nuk mbaron me kaq, jemi duke vazhduar përgatitjen e porosive për vitin në vijim që do të krijojnë mundësi e lehtësi për personelin krijues në përgatitjen e programeve të të gjitha llojeve.

Megjithatë, pavarësisht nga tërë këto që thamë, për t'ju përgjigjur presionit të gjithanshëm të televizioneve private nga më të njohurat në

vendin tonë, dëshirojmë të ngrejmë shqetësimin tonë për nevojën e fondeve shumë të mëdha që nevojiten jo vetëm për ti arritur ata, por edhe për ti tejkaluar për tu bërë një operator televiziv publik si të gjithë operatorët e tjerë të Europës. Përfitojmë nga rasti të ngrejmë kërkesën tonë drejtuar Drejtorisë së TVSH dhe nëpërmjet saj Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH, për fillimin e dixhitalizimit në parametra bashkohorë të prodhimit të programeve televizive.

Sektorët e ndryshëm brenda këtij Departamenti kanë organizuar punën me njëri-tjetrin dhe sektorët e ndryshëm të Departamenteve të tjera në Televizion.

Spektori i profilaksisë gjatë vitit 2009 ka kryer një sërë detyrash, të cilat i kanë shërbyer garantimit të transmetimit, rregjistrimit dhe montazheve brenda kushteve teknike.

Përgjegjësi i sektorit të Profilaksisë së bashku me stafin e tij kanë përballuar me sukses defektet e aparaturës së vjetëruar dhe kjo ka qenë një nga vështirësitë me të cilat janë ndeshur vazhdimisht stafi inxhiniero-teknik i këtij sektori. Kjo edhe për vështirësitë e sigurimit të pjesëve të ndërrimit dhe adoptimet e modifikimet për vendosjen e parametrave të duhur teknik të pajisjeve.

Sigurimi në kohë i pjesëve të ndërrimit, sidomos për pajisjet e montazhit dhe të kamerave duhet të ndiqet me përparësi të veçantë, për shkak se lidhet direkt me cilësinë e materialeve për transmetim.

Spektori teknik i transmetim-rregjistrimit ka kryer me përgjegjësi teknike të gjitha transmetimet direkte dhe rregjistrimet në të treja studiot e Televizionit.

Përgjegjësi i prodhimit ka organizuar dhe shpërndarë punën në bashkërendim me përgjegjësit teknik të turneve duke vënë në shfrytëzim optimal punën teknike. Kjo në bashkëpunim edhe me sektorët e tjerë të Departamenteve të programeve të Strukturës, Prodhimit dhe Drejtorinë e Aktualitetit.

Përgjegjësit e turneve kanë zbatuar me përpikmëri orarin dhe kanë vënë në shfrytëzim aparaturën teknike duke kontrolluar të gjithë parametrat teknike përpara dhe gjatë realizimit të emisioneve të ndryshme, si dhe kanë vënë në efikasitet aparaturën e re dixhitale të instaluar në studiot e Televizionit.

Në Vitin 2009 janë realizuar me sukses:

- Transmetimi i të gjitha informacioneve që kishin të bënin me hyrjen e Shqipërisë në NATO
- Festivali European EUROSONG
- Transmetimi nga çdo pikë e Shqipërisë i informacioneve të fushatës elektorale të të gjitha partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet politike të qershorit 2009, në mënyrë të veçantë të datës 28 qershor dhe javës që pasoi këtë datë.
- Ngjarje të ndryshme dhe të rëndësishme sociale apo politike si brenda dhe jashtë vendit, etj
- Emisione të shumta në studiot e TV si transmetime direkte apo rregjistrime, një pjesë e mirë e të cilave ishin prodhime që realizoheshin për herë të parë.
- Përgatitja për Festivalin 47 të Këngës në RTSH
- Përgatitja e programit festiv të Vitit të Ri
- Koncertet e Vjenës dhe Venecias me rastin e Vitit të Ri

të cilat në sajë të përkushtimit të stafit inxhiniero-teknik, janë përballuar me sukses.

Teknikët e figurës, zërit dhe magnetoskopeve janë përpjekur dhe kanë mbuluar me punë cilësore të treja studiot e TV.

Teknikët e Studios nr.2 kanë mbuluar transmetimet gjatë 24-orëve.

Teknikët e Studios nr.1 kanë bërë të mundur realizimin e emisioneve të ndryshme duke punuar dhe me orare të zgjatura, në bashkëpunim me forcat krijuese.

Gjithashtu kanë mbuluar me punë edhe Studion nr.3, ku realizohet emisioni i mëngjesit dhe programi satelitor.

Spektori i dispecerisë është munduar të mbajë në kushte pune, brenda parametrave teknik, kamerat e operatorëve, pavarësisht vështirësive teknike për gjetjen e pjesëve të këmbimit.

Spektori i telefonisë, elektrikut e kaldajës, është munduar të realizojë detyrat e tij sipas rregullores së RTSH.

Përgjegjesi i këtij sektori ka organizuar punën me sektorin e profilaxisë dhe atë të transmetim-rregjistrimit duke bërë të mundur mosndërprerjen e transmetimeve apo të rregjistrimeve në Studiot e TV për shkak të mungesës së energjisë, duke mbajtur në efikasitet sistemin e baterive dhe motor-gjeneratorin.

Megjithatë jemi të mendimit që në këtë sektor duhet të punohet shumë për të bërë ndryshimet e nevojshme. Duhet të pranohet se në këtë sektor është punuar keq gjatë 10 viteve të fundit. Zgjerimi teknologjik i TVSH është shoqëruar me një punë të pamjaftueshme, edhe kur është bërë, ka qenë aspak profesionale dhe kjo vihet re sot në figurën e prodhuar nga ne. Le të kujtojmë ndërtimin e News Room-it, ku të gjitha punimet elektrike janë kryer nga njerëz që nuk janë pjesë e departamentit teknik të TVSH. Po ashtu le të kujtojmë punime të ndryshme që janë bërë brenda teknikës së TVSH ku kabllo të ushqimit elektrik janë shtrirë në të njëjtat kanale me kabllo të sinjaleve audio dhe video gjë që është rreptësisht e ndaluar.

Në të gjithë sistemin elektrik të Tiranës është futur rrjeti 20kV. Nuk ka asnjë arsye që TVSH të mos lidhet me këtë rrjet, i cili siguron qëndrueshmëri dhe furnizim të pastër. Por ribërja e rrjetit të ushqimit elektrik të teknologjisë televizive sot nuk është aspak një gjë e lehtë. Kjo pjesë e teknikës duhet të ribëhet tërësisht. Ne mbetemi me shpresën se fillimi i projektit të dixhitalizimit të prodhimit të programeve tona nuk do të jetë i largët, në të kundërt këtë punë duhet ta shohim me seriozitetin më të madh.

Sektori teknik është i ndërgjegjshëm se ndërhyrja në teknologjinë e studiove ekzistuese duhet të jetë e vazhdueshme. Është kjo arsyeja që këte vit janë marre të gjitha masat për të zëvendësuar të tre kamerat e studios nr.3 (te cilat janë në përdorim prej 17 vjetësh), të kamerës që transmeton lajmet nga News Room-i, e cila do të hiqet dhe do të zëvendësohet me dy kamera të një cilësie të lartë, si dhe do të shtohen dy kamera në studion nr.1 dhe katër kamera në studion levizës nr.1.

Do të vazhdohet përmirësimi i ndricimit artistik dhe do të futen perzjerës të rinj figure dhe zeri në transmetim në studio dhe në studion levizës. Gjithashtu do të përmirësohet nderlidhja midis ambienteve të ndryshme të punës, sidomos midis regjive dhe studiove.

Vazhdimisht është folur dhe vazhdon të flitet se një nga problemet më të mëdha të teknikës së televizionit është moshë mesatare relativisht e madhe e punonjësve të tij. Sigurisht kjo nuk mund të mohohet. Është kjo arsyeja që në prurjet e reja në rradhët e teknikës në po orientohemi drejt moshave të reja si p.sh në sektorin e studiove levizës u morren në punë tre djem të rinj me njohuri të larta të kompjuterit dhe gjuhëve të huaja. Megjithatë, për mendimin tim, mungesa më e madhe është mentaliteti i vjetër. Pak njerëz ka në sektorin teknik që përpiqen për të njohur më të rejtat e fundit në sektorin televiziv. Sigurisht kjo është për të ardhur keq, por edhe në kemi mundësi të bëjmë më shumë. Në mënyrë të veçantë duhet të forcojmë punën

tonë në trajnimin e vazhdueshëm të personelit teknik. Dikur kjo bëhej në mënyrë të rregullt nëpërmjet kurseve të kualifikimit dhe të specializimeve jashtë shtetit. Të dy këto mënyra sot nuk përdoren fare. Ka kohë që në TVSH nuk zhvillohen kurse të tilla apo dërgohen njerëz për specializime jashtë shtetit. Përrjashtim bën rasti i fundit kur drejtoria e TVSH, e ndodhur para faktit që asnjë prej punonjësve tanë nuk ishte në gjendje të përdorte pajisjet e reja të montazhit jo-linear, duke mos dashur të largonte nga puna personelin ekzistues, organizoi zhvillimin e kurseve të kualifikimit, duke angazhuar specialiste të mirëfilltë të asaj fushe. Ky rast duhet të na shërbejë si fakt që specializimet e këtij lloji të bëhen me të gjithë sektorët e teknikës, duke shfrytëzuar mundësitë që janë të pranishme në vendin tonë (njerëz dhe kompani që merren me përgatitjen e personelit) dhe jashtë shtetit, ku qoftë nëpërmjet organizmave ndërkombëtare, qoftë nëpërmjet marrdhënieve me televizionet partenere europiane mund dhe duhet të dërgohen njerëzit tanë më të mirë për të bërë ata më të aftë të perballojnë teknikisht shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e teknologjisë bashkohore dixhitale. Do të jenë pikërisht këta njerëz që do të përgatisin njerëzit tanë të jenë të aftë të përballen me teknologjinë e së ardhmes.

Jemi të detyruar të pranojmë se jo rrallë herë pjesëtare të ndryshëm të teknikës nga mungesa e vëmendjes dhe kujdesit janë bërë shkak të shfaqjes së problemeve teknike në ekran. N.q.s me përpara për raste të tilla jemi mjaftuar me këshillime dhe vërejtje, gjatë vitit 2009 kemi kaluar në masa dënimesh financiare. Megjithëse kemi qenë të ndërgjegjshëm se këto masa nuk ishin të lehta, mendojmë se ishin të domosdoshme për menjanimin e defekteve në ekran dhe jemi të mendimit se duke kombinuar masat këshilluese administartive me dënimet ekonomike, do të parandalojmë rastet e sipër përmendura.

Vetëm personeli teknik i studiove të televizionit është afërsisht 30 veta. Nga këta pjesa më e madhe punojnë në transmetim. Ata janë të detyruar të punojnë çdo ditë të javës, përfshirë këtu të dielat dhe festat. Meqënëse ditët festive janë në një numër jo të vogël, koha e mbi-punës rezulton shpesh herë më e madhe se koha e lejuar në muaj. Për më tepër, me të njëjtin personel jemi të detyruar të punojmë edhe gjatë kohës së lejes së zakonshme (e cila ndahet 2-3 pjesë të detyruar nga puna) si dhe gjatë rasteve të mungesave për shkak sëmundje. Të gjitha çfarë përmendëm më sipër, sjellin si pasojë që të krijohen vështirësi në pagesën e mbi-punës sidomos për këtë kategori teknikësh. Ky është një problem i cili duhet menjanuar. Ne shtrojmë para drejtorisë së TVSH zgjidhjen e këtij problemi

duke marrë në punë një grup prej 4-5 teknikësh të cilët do të bëjnë të mundur zëvendësimet e nevojshme për uljen e punës mbikohe.

SEKTORI I FINANCËS

1. Ndarja e brendshme e punës:

Sektori i Financës në Drejtorinë e Televizionit përbëhet nga një personel prej 6 vetash, Shefi i Sektorit të Financës, Ekonomistia e pagave, Ekonomistia e blerjeve e magazinave, Arkëtaria dhe Magazinjeri.

Detyrat funksionale të sektorit të Financës janë si më poshtë :

1. SHEFI I SEKTORIT TË FINANCËS

- Ndjek në mënyrë kronologjike regjistrimin e kontabilizimin e Ditarit të Bankave.
- Mban kontakte të përditëshme me Drejtorinë Ekonomike të RTSH për kërkesat për çelje fondi.
- Rakordon me sektorët e tjerë në TVSH. Për ekzekutimin e projekteve të ndryshme.
- Plotëson të gjitha u/xhirimet dhe çequet pasi plotësohet urdhër prokurimi me faturat përkatëse dhe furnizon arkën e institucionit nëpërmjet çeqeve bankare për zgjidhjen e problemeve operative të ditës.
- Bashkëpunon dhe kontrollon me ekonomistët e sektorit për zbatimin e detyrave ditore dhe mujore si marrëdhëniet me arkën, magazinat dhe f/hyrejet e f/daljet e përditshme.
- Kontrollon dhe mban process verbale me antarët e zyrës për mosplotësimin e detyrave të ngarkuara.

2. LLOGARITARJA E MAGAZINAVE

- Rregjistron në mënyrë kronologjike në ditarin e faturave të blerjes çdo faturë që është e rregullt, pa korrigjime me firmat e blerësit dhe të shitësit sipas ligjeve në fuqi.
- Rregjistron në ditarin e magazinave të gjitha f/h dhe f/d dhe në funde të muajit rakordon me magazinën.
- Rakordon me Drejtorinë e tjera të RTSH për të gjitha transferimet dhe mban process verbale me palët përkatëse.

- Për çdo vit bashkë me grupin e inventarizimit të ngritur nga Drejtoresha e TVSH merr pjesë dhe zhvillon inventarin e të gjitha vlerave materiale në TV duke u mbështetur në vendimin nr.70 të KM
- Në fund të çdo viti ushtrimor përgatit fletë kontabilizimet për faturat, f/h, f/d dhe transferimet me drejtoritë e tjera dhe i dorëzon me firmë pranë shefit të financës.

3. LLOGARITARJA E PAGAVE

- Rregjistron në ditarin e arkës çdo ditë veprimet që kanë të bëjnë me arkën si M/P dhe M/A
- Përgatit sipas rastit të gjitha listë pagesat që kanë të bëjnë me dietat dhe honoraret.
- Përllogarit shumat në urdhër shërbimet e punonjësve dhe pasi i firmos te Drejtoresha i kalon për ekzekutim në arkë.
- Ndjek në mënyrë sistematike të gjithë debitorët dhe kreditorët që krijohen në arkë.
- Në çdo dt. 30 të muajit përgatit listë pagesat e pagave dhe të mbikohës për të gjithë punonjësit e TVSH.

4. LLOGARITARJA E ARKËS

- Nën mbikqyrjen e Llogaritares së pagave pret të gjitha m/p dhe m/a dhe i rregjistron në librin e arkës.
- Komunikon me bankat për tërheqjen e vlerave monetare në bazë të çekut të firmosur nga shefi i financës dhe drejtoresha e TVSH dhe në mënyrë të menjëhershme i bën hyrje në arkën e TVSH.
- Plotëson librat e pagave për çdo punonjës
- Plotëson librezat e punonjësve për sigurimet shëndetsore.

5. MAGAZINIERI

- Pret në çdo raste flete hyrjet me paraqitjen e faturës dhe mallit dhe bën kontrollin fizik të çdo lloj malli që është blerë apo është transferuar
- Me paraqitjen e urdher dorëzimit pret fletë daljet për të gjitha kërkesat e punonjësve.
- Mban kartelat financiare për çdo mall dhe hap kartela të reja për mallrat e rinj të ardhur në TVSH.
- Në dt. 5 të çdo muaji dorëzon te ekonomistia e magazinës të gjitha f/h dhe f/d

- Kujdeset për ruajtien e mirë administrimin e mallrave që ka në ngarkim në magazinë dhe kur konstaton paregullsi relatton në drejtorinë e TVSH nëpërmjet proces verbaleve

2. ANALIZA E TREGUESVE EKONOMIKË PËR VITIN 2009

Për vitin 2009 Drejtoria e TVSH ka pasur një plan buxheti të miratuar nga Drejtoria Ekonomike e Drejtorisë së Përgjithshme në shumën e 172 651 lekë.

Në analizë të përgjithshme duke e krahasuar me planin shpenzimet faktike rezultojnë me një ulje të shpenzimeve prej 2 116 lekë.

	Plani	Fakti	(+ -)
Totali i shpenzimeve	172 651	170 535	- 2 116

Kjo ulje ka ardhur si rezultat i një pune të kujdeseshme dhe të mirë organizuar duke i qëndruar korrekt planit të buxhetit dhe është e pasqyruar në zërat e mëposhtëm :

- Paga personeli të përhershëm.....139 lekë
- Sigurimet Shoqërore812 “ “
- Materiale kryesore258 “ “
- Energji Elektrike 72 “ “
- Ujë.....216 “ “
- Telefon 116 “ “
- Shpenzime interneti.....152 “ “
- Qera marie ambientesh.....290 “ “
- Shpenzime të tjera.....296 “ “

Në total këto zëra japin ndikim pozitiv në shpenzimet e përgjithshme në shumën e **2 351** lekë, pavarësisht këtij fakti, në shpenzimet vjetore me tejkalim të shpenzimeve paraqiten këto zëra :

- Paga Part – time.....306 lekë
- Udhëtim e dieta122 “ “
- Honorare 82 “ “

SHUMA 510 lekë

Këto tejkalime kanë ardhur si rezultat i mos planifikim të saktë nga ana e drejtorisë ekonomike të RTSH për pagat Part Time, dietave dhe honorareve.

Në zërin Honorare tejkalimi prej 82 lekë vjen si rezultat i pageses së disa punonjësve në formë honorari dhe jo në formë page përkundrejt kontratave personale me këta persona .

Në zërin udhëtim e dieta tejkalimi prej 122 lekë ka ardhur si rezultat i mos pasjes parasysh të rritjes së numurit të emisioneve në Drejtorinë e Televizionit.

Në zërin Part Time tejkalimi prej 306 lekë ka ardhur si rezultat i mos pasjes parasysh nga ana e Drejtorisë Ekonomike të RTSH i kohëzgjatjes së kontratave me këta punonjës.

Për vitin 2009, Sektori i Financës me gjithë vështiresitë që ka pasur në drejtim të kualifikimit duke mos u përshtatur me programin informatik “Financa 5”, pasi siç dihet e gjithë veprimtaria ekonomike financiare në Drejtorinë e Televizionit prej një viti është e hedhur në këtë program, por me gjithë këto sa thamë më lart personeli në sektorin e financës është munduar që të realizojë detyrat e tij në bazë të funksioneve përkatëse, por gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në kemi hasur disa vështirësi dhe mendojmë që për vitin 2010 nga Departamentet dhe Sektorët e TVSH të kihet parasysh këto fenomene :

-Të gjitha kërkesat për blerje të bëhen me specifikime teknike, të shënohen sasishtë përkatëse të mallrave dhe të eliminohen rastet e blerjeve urgjente.

- Në mbështetje të Udhëzimit nr. 2 datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” të mos përsëriten rastet e blerjeve nga individë jashtë komisionit të prokurimit.

-Të bëhen planifikime mujore nga Departamentet për të gjitha kërkesat e blerjeve të mallrave e shërbimeve, pasi kjo do të ndihmonte ecurinë normale të punës në respektimin e afateve.

- Të respektohet në maksimum Urdhëri i brendshëm i Drejtorisë për paisjen me faturë tatimore i të gjitha urdhër shërbimeve
- Të gjithë punonjësve të jashtëm i duhet bërë e qartë që për marrjen e honorareve duhet të pajsen me nr. llogarie

Burimet njerëzore

Zbatimi i Vendimeve të K. D. të RTSH e Drejtorit të Përgjithshëm.

Gjatë vitit 2009 janë hartuar, në bazë të propozimeve të bëra nga drejtorët e departamenteve të TVSH, Strukturat Organizative dhe ndryshimet në Librin e Pagave, të cilat janë miratuar me Vendimin nr. 23 të KD, date 26.05.2009 dhe Vendimin nr. 43 të KD, datë 17.11.2009 dhe mbi bazën e tyre është punuar gjatë gjithë vitit që sapo mbyllëm. Këto struktura dhe pagat e reja ka patur si qëllim eliminimin dhe minimizimin e “rrjedhjeve” nga institucioni si dhe mbijetesën, në kushtet e konkurrencës së operatorëve të tjerë privatë. Tendanca për të mos bërë shtim të numrit të vendeve të punës në strukturë ka bërë që përsëri të jetë e hapur nevoja e ndryshimeve në të, pasi dhe dinamika e zhvillimit të institucionit tonë në veçanti dhe aktiviteteteve të medias janë gjithmonë në rritje e sipër.

Kontratave të punës

Gjatë këtij viti, nuk janë vërejtur vështirësive gjatë zbatimit të këtyre kontratave (part-time, kohë-provë, të komanduar). Kjo si pasojë dhe e minimizimit të këtyre kontratave dhe lidhja e tyre vetëm atëhere kur është parë e domosdoshme.

Prezenca në punë

Një nga problemet e vazhdueshme dhe pak të riparueshme ka qenë dhe mbetet frekuentimi i orarit të punës nga të gjithë punonjësit e drejtorisë tonë. Gjatë 2009 janë bërë kontrole të herë pas herëshme, të cilët kanë rezultuar me mungesa të shumta edhe pse është tërhequr vëmendja se do të merren masa konform Ligjit 7961 për „Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë“ si dhe Kontratës Individuale të Punës, kushtet e së cilës jemi të detyruar ti zbatojmë të gjithë.

Lejet e zakonshme

Është vënë re që nuk ndiqet praktika e hartimit të kërkesës për kryerjen e lejes, por komunikimi verbal (shef + punonjës) mbyll të gjithë procesin e kryerjes ose jo të saj, gjë e cila dëmton punën e burimeve njerëzore. Kjo pikë mbetet për tu korigjuar gjatë vitit në vazhdim. Duhet të kihet parasysh nga drejtorët e departamenteve që për çdo propozim (marrje

në punë, largim nga puna, vërejtje, gjobë, zëvendësim, etj), kërkesë për leje, shpërblim, duhet të hartohet shkresa përkatëse e cila i kalon eprorit për miratim dhe është detyrë e burimeve njerëzore të bëjë zbardhjen e saj.

Trainimi i punonjësve

Për të përballuar konkurrencën në rritje në tregun e medias sot, u pa e nevojshme të bëhej një testim me punonjësit e sektorit të montazhit i cili nxorri si domosdoshmeri nevojën e trainimit të tyre. Edhe pse në fillimet e saj si praktikë, kjo risi, rezultoi shumë e frytshme dhe do të vazhdoje të aplikohet gjatë vitit në vazhdim, për t'i dhënë një impuls të ri ekranit të TVSH, gjë e cila do të ndikojë në rritjen e mbarëvajtjes dhe cilësisë së punës në të gjithë sektorët.

Politikat e rekrutimit dhe të punësimit

Duke qenë se gjatë 2009 janë marrë punonjës të rinj në punë është patur parasysh që kriteret e punësimit të jenë gjithmonë në zbatim të ligjit 8410, Statutit të RTSH, vendimeve të Keshillit Drejtues dhe Drejtorit të Përgjithshëm RTSH. Si kriter kryesor përzgjedhës ka qenë dhe do të mbetet profesionalizmi dhe aftësia e punës në grup.

Dosjet e personelit

Kujdes i veçantë gjatë vitit 2009 i është kushtuar përpilimit, ruajtjes dhe rifreskimit të herëpashershëm të dosjeve personale për çdo punonjës të TVSH si dhe librezat e punës në të cilat pasqyrohen të gjitha lëvizjet për sejcilin prej tyre. Edhe pse ju është kërkuar herë pas here punonjësit kanë mangësi në dorëzimin dhe rifreskimin e dokumentacionit të tyre personal.

Listë prezencat Mujore

Çdo datë 30 të fundit të muajit, sejcili prej drejtorëve të departamenteve duhet të dorëzojë pranë Burimeve njerëzore, listëprezencën në punë, pasi kjo shkresë është njësi matëse e punës së sejcilit prej punonjësve dhe në bazë të saj bëhet pagesa e tyre mujore. Hartimi i kësaj listëprezence kërkon përgjegjësi pasi janë vërejtur mospërputhje nga të dhënat që shkruhen aty, me ato në realitet (dmth një punonjës figuron në

punë në listëprezencën e hartuar nga shefi i sektorit, ndërkohë që ka dorëzuar raportin mjeksor në financë).

*
* *

Përfundime:

3. Nga analiza e mësipërme rezulton se **prodhimet në TVSH në harkun kohor të dymbëdhjetë muajve të fundit kanë pësuar një rritje të mëtejshme prej mesatarisht 10 orësh në javë, 78,57 % të kohës së përgjithshme të transmetimit ose 96,7 % të kohës në dispozicion të TVSH (pa kohën e edicioneve informative të Drejtorisë së Aktualitetit dhe Redaksisë së VOA).**
4. Krahasuar me të njëjtën periudhë të fillimit të këtij mandati (nëntor 2006), rritja është në masën **579 %** të kohës së përgjithshme televizive ose **470 %** të kohës së transmetimit në dispozicion të TVSH (pa kohën e edicioneve informative të Drejtorisë së Aktualitetit dhe Redaksisë së VOA).
5. Problemi më emergjent i manaxhimit të kohës televizive në dispozicion të Drejtorisë së TVSH, megjithë tematizimin e vazhdueshëm në të gjitha analizat tona vjetore dhe raportimet në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH dhe në Këshillin Derejtues të RTSH vazhdon të mbetet paqëndrueshmëria e gjatësisë së minutazhit të edicioneve informative, nën manaxhimin e Drejtorisë së Aktualitetit. Kështu shtimit të konsiderueshëm të minutazhit në dispozicion të të edicioneve informative (nga 21 në 31,5 orë në javë), e ardhur jo vetëm si pasojë e shtimit të edicionit të lajmeve të “Zërit të Amerikës” (30 minuta në ditë) dhe lajmeve në gjuhën angleze (15 minuta në ditë), por dhe nga zgjatja e edicioneve informative përtej minutazhit të miratuar në strukturat programore përkatëse me rreth 60 minuta në ditë, i shtohet edhe pamundësia e përlllogaritjes së kësaj zgjastjeje mnga dita në ditë. Kështu ndodh që situatë ose bëhet shkak që programet të shtyjnë njëri-tjetrin në mënyrë të pabukur ose krijojnë probleme të mëdha për riorganizimin e programacionit në Drejtorinë e

TVSH, duke u bërë shkak për vendime të minutës së fundit, të cilat reflektohen edhe në ekran si improvizime.

6. Problematik vazhdon të mbetet edhe plotësimi i detyrimit të TVSH për pasqyrimin e veprimtarisë së Kuvendit dhe institucioneve të tjera politike në vend. Çdo të hënë dhe të enjte – në përputhje me axhendën e Kuvendit të Shqipërisë TVSH është në pritje të lidhjes me të. Si kohëzgjatja e transmetimeve ashtu edhe momenti i fillimit të transmetimit tonë (i cili jo gjithmonë përputhet me fillimin e seancës) nuk dihen saktësisht. Ato përcaktohen nga vullneti i punonjësve përkatës të shtypit, të cilët manaxhojnë situatën sipas rastit. Megjithë përpjekjet dhe sugjerimet tona, deri tani nuk kemi arritur, që midis RTSH, Kuvendit dhe institucioneve të tjera të politikës qendrore të vendit të lidhet një marrëveshje, në bazë të së cilës, monopolin e transmetimit të drejtpërdrejtë ta kenë vetëm ngjarjet e jashtëzakonshme, festat kombëtare dhe fetare, të cilat e justifikojnë prishjen e programit, me synim informimin e publikut me të rejat e fundit ose hartimin e programit ditor në një formë të veçantë duke marrë parasysh axhendat e bëra të njohura kohë më parë. Në një marrëveshje të tillë, në të gjitha rastet e tjera seancat e rëndësishme parlamentare mund të transmetohen në mbrëmje pas edicionit të informativ të orës 22.30, duke mos prishur rrjedhën normale të programit ditor dhe duke mënjanuar situatat e papastra teknikisht të reagimit të atypëratyshëm.
7. Pavarësisht nga problemet, në periudhën në shqyrtim, **grila programore e TVSH u stabilizua** përfundimisht si **në dimension ditor** – ditët e javës kanë “fytyrat” e tyre programore, ashtu edhe **në dimension javor** – përmes profilizimit të fashë-orareve javore, me synim orientimin e teleshikuesve dhe krijimin targeteve të qëndrueshme të teleshikuesve.
8. Gamës së formateve të ofruara iu shtua edhe **ofrimi i dy emisioneve të reja** të përjavshme **për fëmijë**, i rubrikës së përditshme **të gatimit dhe aerobisë**, i **udhëtimit kulinarik** të përjavshëm dhe **turistik** të përjavshëm (ende në prodhim) **në trevat e vendit**, i **telenovelës** së përditshme, i **filmit vizatimor** të përditshëm, i **serialeve të dokumentarëve premierë** si edhe i **serialëve humoristikë**.

6.1. Për shkak të paaftësisë së ofruesit për të plotësuar

dokumentacionin e kërkuar, nuk u arrit të realizohet objektivi i Drejtorisë së TVSH për blerjen e një seriali policor.

- 6.2. Mungesa është menduar të plotësohet me oferta falas nga fondi i orëve të programeve falas që EBU ofron për anëtarët e vet. Aktualisht është mbyllur studimi i ofertës përkatëse dhe përcaktimi i interesave tona dhe pritet reagimi i palës tjetër. Po kështu është vepruar edhe me ofrues të tjerë, si psh. RAI, ARTE, CFI, Deutsche Eëlle, etj.
 - 6.3. Po kështu nuk u arrit të konkludohej – për rezerva në vlerësimin e ofertave dhe projekteve, të ardhura si nga brenda institucionit ashtu edhe nga jashtë tij – në procesin e përzgjedhjes së formatit të përjavshëm të spektaklit, të prodhuar nga vetë TVSH.
 - 6.4. Në këto kushte dita e shtunë/mbrëmja e spektaklit është menduar të manaxhohet nëpërmjet transmetimit të: 1) cikleve të bashkëprodhuara me të tretë, 2) spektakleve të prodhuara nga të tretë (brenda dhe jashtë vendit) qoftë më vete, qoftë në kuadrin e evenimenteve artistike dhe sportive kombëtare dhe ndërkombëtare, si psh: Netët e klipit, Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës, Hedhja e shortit për Kampionatin Botëror të Futbollit, Afrika 2010, Hapja e Olimpodës dimërore Vancouver 2010, Festivali i San Remos, Eurosongu, etj.
9. Në ndryshim të traditës së deritanishme të RTSH, sipas së cilës manaxhimi mediatik i fushatës zgjedhore mbulohej me cikle emisionesh, të përgatitura nga Drejtoria e Aktualitetit, Drejtoria e TVSH hodhi në treg **një cikël të sukseshëm emisionesh politike, të titulluar “DUEL”, me të cilin u dëshmuua paanësi politike, novatorizëm në përzgjedhjen e formatit dhe profesionalizëm në pasqyrimin e fushatës zgjedhore.**
- 7.1. Megjithëse rezultoi i sukseshëm si format dhe ishte menduar të vazhdonte sipas një koncepti të përshtatur me nevojat më afatgjata të ekranit të TVSH veçanërisht në drejtim të rishikimit

të historisë së Shqipërisë dhe personazheve të njohura historike, “Duel” nuk ka marrë ende miratimin e startimit të tij.

10. **Të gjitha emisionet** e manaxhuara nga Drejtoria e TVSH **janë politikisht të ekuilibruara** – formatet e debateve të konceptuar si **hapësirë prononcimi për të gjitha forcat politike**, strukturat e shtetit dhe shoqërinë civile, ndërsa prania e publikut në to hap mundësinë e paraqitjes së drejtpërdrejtë të mendimit të tij kritik.

11. Nga pikëpamja organizative, gjatë vitit 2009 janë marrë këto masa konkrete manaxhimi:

- Hartimi dhe propozimi i ndryshimeve të Strukturës organizative për Drejtorinë e TVSH si edhe i Librit të ri të pagave për Drejtorinë e TVSH
- **Mbyllja e diskutimit të Projekt-Rregullores se re për Drejtorinë e TVSH** dhe dorëzimi i saj në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH
- **Mbyllja e diskutimit të Projekt-Tarifave të reja të shpërblimit të krijimtarisë** për Drejtorinë e TVSH dhe dorëzimi i saj në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH
- **Instalimi** i pajisjeve të tjera të teknologjisë së fundit në vazhdimësi të “Projektit të Dixhitalizimit”.
- **Instalimi** i teknologjisë së fundit të ndriçimit (robotëve) në Studion Nr.1
- **Dixhitalizimi** i studiove të montazhit
- **Testimi paraprak i personelit** të studiove të montazhit
- **Trajnimi i personelit** të studiove të montazhit (për herë të parë në RTSH)
- **Vënia në efektivitet** të vazhdueshëm në një rreze prej 360° e të gjitha studiove të prodhimit
- **Rinovimi me koncept konvencional i të gjitha dekoreve** (me përjashtim të emisionit “7X7”)
- **Krijimi, paisja dhe vënia në efektivitet me kapacitet të plotë e studios Nr.5** të prodhimit dhe transmetimit të TVSH – Kuzhina
- **Hartimi i projektbuxhetit afatmesëm për Drejtorinë e TVSH** në përputhje me objektivat e politikave afatmesme të drejtimit për Drejtorinë e TVSH

12. Përvoja e trajnimit të kryer gjatë vitit të shkuar në Departamentin e prodhimit të Drejtorisë së TVSH, tregoi, se trajnime të tilla janë të domosdoshme në të gjitha strukturat e kësaj drejtorie. Në këto kushte gjykojmë, se trajnimi i burimeve njerëzore jo vetëm brenda TVSH, por edhe në nivel RTSH-je ka nevojë për një strategji të menduar mirë, në të cilën të përfshihen:

- kriteret e testimit të personelit dhe të ngritjes së komisioneve përkatëse
- përcaktimin e tarifave të pagesës së anëtarëve të komisioneve përkatëse
- hartimin e planeve kohore të kryerjes së testeve
- koordinimin e nevojave për kualifikim të rrjedhura nga ky testim me nevojat për kualifikim, që rrjedhin nga ndryshimi i vazhdueshëm i teknologjisë në kuadrin e procesit/projektit të dixhitalizimit
- përcaktimin e platformave konkrete në përputhje me të dyja llojet e nevojave të mësipërme
- përcaktimin e grafikëve konkretë të trajtimit, duke pasur parasysh mospengimin e prodhimit dhe aktivitetit të përditshëm të TVSH
- përcaktimin e ekipeve efikase të trajnerëve, të aftë për të përballuar sfidën e kualifikimit të gjithanshëm
- përcaktimin e tarifave të pagesës së trajnerëve
- përcaktimin e kriterëve të testimit përfundimtar) të personelit (në mbyllje të trajnimit) dhe të ngritjes së komisioneve përkatëse
- përcaktimin e tarifave të pagesës së anëtarëve të komisioneve përkatëse
- përcaktimin e penaliteteve për rastet e mungesës së efektivitetit të trajnimit për punëmarrësit

Objektiva për vitin 2010

1. Administrata

1. Rritja e pagave, si mundësi për thithjen e forcave të specializuara (10%)
2. Lidhja në rrjet e punonjësve të administratës
3. Azhurnimi me programe kompjuterike bashkëkohorë të manaxhimit (ERP) - Shkalla 1
4. Hartimi dhe zbatimi i seminareve trajnuese të manaxhimit, koordinimit dhe administrimit (4 në vit)
5. Plotësimi i zyrave me materiale dhe pajisje shtesë për rritjen e produktivitetit dhe cilësisë së punë
6. Meremetim i pjesshëm ndërtese (400 000 lekë)

2. Prodhimi

1. Rritja e prodhimit në masën 5%
2. Rikonceptimi i fashës-orar të pasmbremjes (23.00-00.00) në shërbim të rritjes së audiencës.
Futja e SERIALIT POLICOR, FILMIT HUMORISTIK, SERIALIT DOKUMENTAR
3. Ristrukturimi dhe konsolidimi i fashës-orar të pasditës (16.40-18.00) në shërbim të rritjes së audiencës.
4. Vijimi i prodhimit të markave të suksesshme dhe produkteve të adaptuara me audiencë të gjerë
5. Ideimi dhe prodhimi i një formati special për fëmijë (SPEKTAKEL PER FEMIJE)
5. Plotësimi i gamës së formateve të ofruara (Realizimi i prodhimit të SERIALIT TELEVIZIV)
6. Rritja (10%) e peshës specifike të produkteve të adaptuara (film, sport, spektakël, etj.) në programacion
Ofrimi i 2 TELENOVELAVE
7. Rritja (11%) e bashkëpunimeve me të tretë në projekte artistike dhe filmike.
8. Rinovimi i faqesjes (shtim i peshës së elementëve interaktivë në dekor dhe rifreskim i imazhit grafik)
9. Ristrukturimi organizativ në shërbim të prodhimit dhe rritja e pagës(10%) si motivim për rritjen e cilësisë

3. Blerjet e të drejtave të transmetimit

1. Rritja (10%) e peshës specifike produkteve të adaptuara (me të drejta transmetimi të blera nga TVSH)
2. Blerje të drejtash (nga prodhues vendas) në gjininë e filmit artistik FEATURE (10 orë)
3. Blerje të drejtash (nga prodhues të huaj) në gjininë e filmit artistik FEATURE (60 orë)
4. Blerje të drejtash (nga prodhues të huaj) në gjininë e SERIALIT POLICOR (104 orë)
5. Blerje të drejtash (nga prodhues të huaj) në gjininë e TELENOVELES (156 orë)
6. Blerje të drejtash (nga prodhues të huaj) në gjininë e KINOKOMEDISE (52 orë)
7. Blerje të drejtash (nga prodhues të huaj) në gjininë e FILMIT VIZATIMOR (78 orë)
8. Blerje të drejtash (nga prodhues të huaj) në gjininë e FILMIT DOKUMENTAR (52 orë)
9. Blerjen e së drejtës (nga të huaj) së përdorimit të MARKES për spektaklin e javor të TVSH (46 javë)
10. Blerje të drejtash transmetimi për evenimente të rëndësishme kulturore kombëtare dhe ndërkombëtare (orët përcaktohen nga Drejtoria e Përgjithshme e RTSH)
11. Blerje të drejtash transmetimi për evenimente të rëndësishme sportive kombëtare dhe ndërkombëtare (orët përcaktohen nga Drejtoria e Përgjithshme e RTSH)
12. Blerje të drejtash (nga të huaj) në gjininë e KONCERTIT DHE SPEKTAKLIT (25 orë)

4. Masa për rinovimin teknologjik

Vazhdimi i modernizimit teknologjik të RTSH.

1. Ndërtimi i studios TV të re.

Blerje e një përzierësi të ri audio me përpunim dixhital të sinjalit, me 32-48 hyrje, me dopio ushqyes, 2 monitorë audio broadcast dhe 2 monitorë audio për interfoninë e studios.

Interfoni regji-studio pa tel me 8 abonentë.

Plotësimi i ndriçimit të studios me prozhektorë të ftohtë dhe të nxehtë, me projektorë ndriçimi për efekte speciale, konsolle ndriçimi deri në programe

tip "show" dhe dimera. Fiksimi mekanik i prozhektorëve me fiksues statikë dhe pantografë.

Pajisje për aparaturën qendrore si "black burst" gjenerator, shpërndarës analogë dhe dixhitalë të sinjaleve audio dhe video me gjithë "frame" të tyre me dopio ushqyes.

Oshilografë dhe rasterizerë për kontrollin e sinjaleve audio dhe video.
Komutatorë figure 10/1 analoge dhe komutatorë figure dixhitale 12/1.

Kran kamere me krah deri në 9 metra të gjatë, me kokë dixhitale që mban deri 15 Kg.

Regjistruues dixhital me kasetë DVCAM (DSR-2000P).

Sistem "play-out" me mundësi rregjistrimi, riprodhimi dhe shkrimi të shkronjave (titrave) me hyrje/dalje SDI.

30 monitorë profesionalë analoge 14", format 4:3, për kontrollin e sinjaleve video.

6 monitorë broadcast dixhitale 20", me format 16:9.

2. Plotësimi i studios nr. 1 të TVSH.

Monitor figure i madh (video wall) me dimensione me LED, me mundësi ndarje të figurës.

Gjenerator për përgatitje grafikash dhe shkrimesh speciale, shoqëruar me një komplet prej 50 "lupash", me hyrje/dalje dixhitale.

Perde jeshile për dy anë të studios, me një kënd të veçantë për virtualizimin e imazhit, me gjithë prozhektorët e ndriçimit të saj.

Pajisje për "TV virtual" me gjithë sensorët e nevojshëm të kokave të rrotullueshme të 3 stativave të kamerave të studios.

Interfoni regji-studio pa tel me 8 abonentë.

Komutator SDI 12/1.

3. Plotësimi i studios nr. 2 të TVSH.

Blerje e një përzierësi të ri audio me përpunim dixhital të sinjalit, me 48 hyrje, me dopio ushqyes.

6 monitorë broadcast dixhitale 20", me format 4:3.

Përmirësim i ndriçimit të kësaj studio (prozhektorë dhe konsole me dimera).

Perde jeshile për dy anë të studios.

Komutator SDI 12/1.

Splitter dixhital për këtë studio.

Monitor figure i madh (video wall) me dimensione me LED, me mundësi ndarje të figurës.

4. Plotësimi i studios nr. 3 të TVSH.

Monitor figure i madh (video wall) me dimensione me LED, me mundësi ndarje të figurës.

Perde jeshile për dy anë të studios me gjithë ndriçuesit e saj.

Përmirësim i ndriçimit të kësaj studio (prozhektorë dhe konsole me dimera).

Splitter dixhital për këtë studio.

Komutator SDI 12/1.

Masa të tjera

1. Rikonstruksioni teknologjik i studiove nr. 1, 2 dhe 3. Zëvendësim pajisjesh të vjetra analoge (kamerat në studion nr. 3) dhe shtimin e dy kamerave në studion nr. 1. Përmirësimi i sistemit të ndriçimit në të tre studiot dhe vendosja e perdeve speciale në studion nr. 1.

2. Zëvendësimi i përzierësit audio në studion nr. 2.

3. Futjen e një gjeneratori shkrimesh dhe grafikë, i pajisur edhe me prodhim audio, në studion nr.1

4. Futjen e "splitter video" dixhitale në studiot nr. 2 dhe 3; pajisjen e studiove nr. 1, 2 dhe 3 me komutatorë të sinjaleve video dixhitale; pajisjen e sektorit të grafikës me teknologji të kohës për prodhime për faqosjen e ekranit, të shoqëruar me një numër të nevojshëm "back-ground-esh"; blerjen e një "big screen për studion nr.2; blerja e një projektori video të fuqishëm me gjithë perde për studion nr. 1;

5. Pajisja e TVSH me një interfoni për të gjithë ambientet e punës.

6. Rikonstruktimin e plotë të autobuzit televiziv, duke shtuar 4 kamera dixhitale profesionale, përzierësin e figurës, pajisjen e ngadalësimit të figurës, pajisjet matëse, pajisjet për shpërndarjen dhe përpunimin e sinjaleve dixhitale, përzierësin e zërit, monitorët e figurës dhe zërit dhe të një "steady-cam" cilësor.

*
* *

Masa për festimin e 50-vjetorit të TVSH

Më 29. prill të këtij viti, Televizioni Shqiptar mbush 50 vjet të aktivitetit të tij. Për festimin dinjitoz të 50 Vjetorit të TVsh-së, planifikojmë të marrim masat e mëposhtme:

1. Transformimin tërësor të hyrjes (hollit) të televizionit dhe ambienteve të tjera të brendshme si me poshtë:

a) – Krijimi i 5 këndeve ku do të pasqyrohet me foto, shifra dhe fakte historia 50- vjeçare e institucionit, personazhet e parë që e filluan qendrën eksperimentale të Televizionit Shqiptar, personeli teknik, spikerat, krijuesit, drejtuesit etj. Në vazhdim, me foto dhe diçitura, arritjet, ku ne kemi qenë gjithnjë të parët, sidomos në krijimtari. Do të pasqyrohen ndryshimet teknike dhe teknologjike, raportet me botën si dhe kalimi në programet satelitore. Po kështu do të vendosen edhe disa data të veçanta që flasin për transformimin e TVSH në vite.

b) – Vendosja në holl e dy monitorëve të mëdhenj, njëri prej tyre do të transmetojë programin ditor dhe tjetri promon e 50 vjetorit të TVSH të përbërë nga:

1. materiali promocional i 50 vjetorit

2. lista shterruese e punonjësve të TVSH në këto 50 vjet

c) - Instalimi i një këndi interneti në të cilin do të ofrohet akses vetëm për faqen e internetit të RTSh.

d) - Rinovimi dhe rikonceptimi funksional i dhomës së dezurnit të TVSH-së. Mendohet që dhoma të pajiset me orëdi më të përshtatshme (në përputhje me imazhin që duhet të japë një institucion në përballjen e parë) dhe para së gjithash me një raft poste për sektorët e TVSh, çka do t'i shërbente sistemimit të postës së ardhur në institucion dhe shpërndarjes së saj pa konfuzion dhe pa lëvizjen e punonjësit të shërbimit nëpër zyra. Sipas këtij koncepti organizatorët përkatës zbresin një herë në ditë për të marrë postën e ditës.

e) – Organizimi i një ekspozite fotografike në hollin e brendshëm të TVSh. Në këtë ekspozitë mendojmë të ndalemi në stacionet kryesore të egzistencës të transmetuesit publik shqiptar si edhe në pjesë të rëndësishme të veprimtarisë së tij sot. Oferta

fotografike do të kombinohet me ofertën audiovizive, përmes 2 deri në 4 plazmave të vendosura në përbërje të ekspozitës në të cilat do të transmetohen prodhime të TVSH në vitë të këtyre formateve:

- 1) spektakle
- 2) dokumentarë
- 3) filma artistikë
- 4) emisione për fëmijë

f) – Konceptit të hollit kryesor do t'i përshtatet edhe mënyra e organizimit të miniholleve të kateve të tjera në të cilat mendohet të prezantohen në mënyrë fotografike sektorët e vendosur në katet përkatëse sipas këtij koncepti.

- Plani i katit dhe sektorët e vendosur në të.
- Fotografi që ilustrojnë procese të punës në secilin prej sektorëve.
- Fotografia e javës ose e muajit.

Në korridoret e brendshme mendohet të zerë vend:

- rregullorja e brendshme e sektorëve përkatës
- planet e punës (grafiku i studiove, turnet, etj.)
- rregullorja e sigurimit teknik
- numrat e emergjencës

Në katin e katërt në ndërtesës së TVSh në të cilin është e vendosur dhe drejtoria e TVSH-së, mendohet të vendosen fotografi e gjithë drejtorëve të këtij institucion në vite.

2. Përgatitja e spotit promociional “50 vjet TVSh”, si dhe i një spoti promociional për kredon e TVSH –së sot, që do të transmetohen të alternuar fillimisht gjatë gjithë prillit, për të vazhduar më tej vetëm me transmetimin e spotit “TVSH sot”.

3. Hapja e një rubrike të posaçme të titulluar “50 vjet TVSH” në faqen e internetit të RTSh. Në këtë rubrikë do të zenë vend të gjitha festivitetet si edhe i gjithë materiali i mbledhur me këtë rast.

3.1. Hapja e rubrikës së veçantë “50 vjet TVSH”, parakupton plotësimin me parametra maksimale të të gjitha të dhënave që prekin

veprimtarinë e TVSH, në plan programor dhe organizativ, në faqen e internetit të TVSh, brenda RTSH-së

4. Realizimi i një filmi dokumentar me rastin e 50 vjetorit të TVSH, i planifikuar për tu transmetuar në dt. 28 ose 29 Prill 2010, në Prime Time
5. Realizimi i një montazhi, në formën e një udhëtimi imagjinar nëpër 50 vitet e TVSH, i cili do të shërbejë si bazë për promon që do të transmetohet në njërin prej ekraneve të vendosur në hollin e TVSh.
6. Organizimi i një mbrëmjeje festive përkatësisht i një spektakli me rastin e 50 vjetorit të televizionit në Shqipëri, në të cilin të ofrohen në mënyrë të kombinuar numra artistikë (muzikorë dhe koreografikë), ilustrime audio vizive të kontributeve të transmetuesit publik në vite (bëhet fjalë për prezantimin e disa zhanreve psh. pjesë nga dokumentarët më të mirë, pjesë nga serialet, pjesë nga varietetë, pjesë nga ngjarjet artistike që kanë bërë epokë, si festivali i 11-të dhe në përgjithësi festivalet në RTSh, pjesëmarrjet në Eurosong, festivalet për fëmijë, intervista të papërsëritshme, pamje nga ngjarje kthesë, si psh. rrëzimi i diktaturës, lufta në Kosovë, etj. Ky spektakël mendohet të organizohet më dt. 29 Prill, ora 18.00 dhe do të transmetohet nga TVSh më dt. 29 Prill ora 21.00.

6.1 Në pamundësi të realizimit të propozimit të mësipërm mund të vijë në vështirë dhe organizimi i Sesionit Shkencor me temë “50 vjet Televizion në Shqipëri”

Në sesion do të referohet për disa tema. Do të preken si probleme që kanë të bëjnë direkt me veprimtarinë e TVSH në vite dhe të perceptimit tonë të brendshëm për këtë ashtu edhe probleme që kanë të bëjnë me vendin e TVSH në treg, aspekte të ndryshme të tregut audioviziv në Shqipëri, çështje të politikave të medias, të perspektivave të zhvillimit teknologjik e kështu me radhë. Ky sesion do të zgjasë deri në dy orë. Për secilën temë do të referohet jo më shumë se 10 minuta. Sesionin do ta përshëndesin edhe titullarë nga Drejtoria e Përgjithshme RTSh. Në sesion do të ftohen, personalitete të medias, punonjës aktualë të TVSH, punonjës të

larguar dhe pensionistë, miq dhe bashkëpunëtorë. Të ftuar do të jenë edhe personalitetet më të larta të shtetit. Ky sesion mendohet të organizohet më dt. 29 Prill në orën 12.00

7. Propozimi i vlerësimit të TVSH me një dekoratë të lartë nga Presidenca e Republikës së Shqipërisë. Në rastin e organizimit të spektaklit akordimi i dekoratës do të jetë pjesë e këtij spektakli. Në rastin e oraganizimit të sesionit shkencor akordimi i dekoratës do të shoqërohet me një koktejl që do të mbyllë festivitete e 50 vjetorit, i planifikuar për tu organizuar me dt. 29 prill në orën 18.00

8. Në muajin prill programi i TVSh do t'i shërbejë këtij evenimenti

- Fasha orare 16.45- 18.00 do të vihet tërësisht në dispozicion të transmetimit të prodhimeve më të mira të TVSH në vite, të ofruara në mënyrë problemore sipas një koncepti të veçantë.
- Fasha orare 23.00 - 00.30 do të vihet në dispozicion të transmetimit të plotë të disa prej produkteve më të spikatura të TVSH në vite.
- Disa programe të strukturës do t'i përshtasin problematikën e tyre, trajtimit të aspekteve të ndryshme të historikut 50 vjeçar të TVSh-së.

- Emisionet “Jo vetëm kafe” dhe “Zig Zag” do të planifikojnë ditë të veçanta të javëve të Prillit në të cilat do të trajtohen probleme të ndryshme të historikut të aktivitetit të TVSh-së.

- Në emisionin “7x7” në 3 javët e para të Prillit do të ftohen disa nga drejtuesit e TVSH në vite, ndërkohë që i katërti do t'i kushtohet tërësisht 50 vjetorit të TVSh-së.

- Në emisionin “Kafeja e së dieles” për katër javë rrjesht do të jenë të pranishëm 4 personazhe, jeta e të cilëve është lidhur ngushtësisht me TVSH, që nga rinia e tyre kur filluan punën këtu.

- Në tri emisionet e “Rubrikës Sportive” të muajit Prill, do të integrohet një minutazh i posaçëm për historikun e këtij emisioni në vite, ndërkohë që Rubrika Sportive e dt, 25 Prill do të konceptohet si një shou – bilanc i ngjashëm me formatin e transmetuar në fund të vitit 2009.

- Drejtorisë së Aktualitetit do t'i propozojmë që javën e fundit në fund të çdo edicioni qendror lajmesh të transmetojë një speciale me “Ekрани ynë në 50 vite”.